



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.36

7 prill

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 249
datë 11.3.2010

Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje prej 37 750 000 eurosh

1317

LIGJ
Nr.10 249, datë 11.3.2010

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUASË DHE PROJEKTIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, E
OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT, SH.A., SI AGJENCIA E ZBATIMIT
TË PROJEKTIT DHE KFW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“LINJA UNAZORE 110 KILOVOLT E SHQIPËRISË SË JUGUT”, NËPËRMJET NJË
HUAJE PREJ 37 750 000 EUROSH**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huasë dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje prej 37 750 000 (tridhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) eurosh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6478, datë 25.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

HUAJE DHE PROJEKTI (DHJETOR 2009) NDËRMJET KFW, FRANKFURT AM MAIN
("KfW") DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCAVE ("HUAMARRËSI") DHE OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
SHA (OST) ("AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT") PËR 37 750 000 EURO (TRIDHJETË
E SHTATË MILIONË E SHTATËQIND E PESËDHJETË MIJË EURO) LINJA UNAZORE
110-KV E SHQIPËRISË SË JUGUT

Hyrje

Bazë e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti është marrëveshja që duhet të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin financiar (FC) ("Marrëveshje Qeveritare").

Me kushtin që Republika Federale Gjermane do të japë subvencione për normat e interesit dhe me kushtin që Republika Federale Gjermane do të japë një garanci për huanë, KfW-ja do të japë një hua në pajtim me dispozitat e kushteve të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti. Termat dhe kushtet e huasë përmbushen me kërkesat e OECD-së që zbatohen në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti për njohjen e Asistencës Zyrtare të Zhvillimit (ODA).

Huaja që jepet, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti është pjesë përbërëse e një pakete për të financuar projektin “Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut”. Dy hua të tjera që do të jepen nga KfW-ja në një shumë deri në 10 750 000 euro dhe në një shumë deri në 500 000 euro në bazë të dy marrëveshjeve të veçanta huaje dhe projekti, ndërmjet KfW-së, Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit (“Marrëveshjet Shtesë të Huasë” do të plotësojnë paketën si pjesë përbërëse (“kjo Marrëveshje e Huasë dhe Projektit dhe Marrëveshjet Plotësuese Shtesë së bashku “Marrëveshjet e Huasë”).

1. Huaja

1.1 Shuma. KfW-ja do t’i japë Huamarrësit një hua që nuk kalon një shumë të përgjithshme prej

37 750 000 euro

(tridhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë euro)

(" Huaja").

1.2 Kanalizimi dhe qëllimi i huasë. Huamarrësi e kanalizon huanë plotësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit, në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit e përdor huanë vetëm për të financuar Linjën Unazore 110-kV në Shqipërinë e Jugut (“Projekti”) dhe kryesisht për të paguar koston e këmbimit të huaj. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja i përcaktojnë hollësitë e projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja në një marrëveshje të veçantë, e cila miratohet nga Huamarrësi.

1.3 Tatimet, detyrimet, tarifat doganore. Tatimet dhe detyrimet e tjera publike që duhet të paguhen nga Huamarrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit, si dhe detyrimet doganore nuk mund të financohen nga huaja.

2. Kanalizimi i huasë në Agjencinë e Zbatimit të Projektit

2.1 Marrëveshja e kanalizimit të huasë. Huamarrësi e kanalizon huanë tek Agjencia e Zbatimit të Projektit, sipas një marrëveshjeje kanalizimi të huasë sipas termave dhe kushteve të parashikuara në nenet 5.1 (Interesi) dhe 6.1 (Shlyerja dhe parapagimi).

2.2 Mungesa e përgjegjësisë për Agjencinë e Zbatimit të Projektit. Kanalizimi i huasë nuk përbën ndonjë detyrim për Agjencinë e Zbatimit të Projektit kundrejt KfW-së për detyrimet e pagesave sipas kësaj Marrëveshjeje të Huasë dhe Projektit.

3. Disbursimi

3.1 Kërkesa për disbursim. Menjëherë sapo të përmushen të gjitha kushtet paraprake për disbursimin, sipas nenit 3.3, KfW-ja e disburson huanë në pajtim me progresin e projektit, me kërkesën e Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Disbursimi do të kryhet në pajtim me grafikun e disbursimit që gjendet në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti. KfW-ja i bën disbursimet deri tek shumat maksimale që përcaktohen për çdo gjashtëmuajor. Në masën që Agjencia e Zbatimit të Projektit kërkon disbursime të shumave më të vogla brenda një gjashtëmuajori, shumat e padisbursuara mund të kërkojnë në gjashtëmuajorët e ardhshëm. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të bëjë më shumë se një disbursim dhe jo në një shumë më të vogël se 100 000 euro për një muaj kalendarik.

Kërkesat për disbursim, sipas Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit, bëhen gjithmonë njëkohësisht me kërkesat për disbursim sipas marrëveshjeve plotësuese të huasë dhe janë të vlefshme vetëm nëse shumat e kërkuara të disbursimit përputhen me sa më poshtë: 77% (me fjalë: shtatëdhjetë e shtatë për qind) e shumës së plotë të disbursimit të huasë sipas Marrëveshjeve të Huasë duhet të bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti, ndërsa pjesa e mbetur prej 23% (me fjalë: njëzet e tre për qind) e shumës së plotë të disbursimit të huasë sipas Marrëveshjeve të Huasë duhet të paraqitet sipas marrëveshjeve plotësuese të huasë. Kjo e fundit përbëhet nga dy pjesë (10 750 000 euro dhe 500 000 euro) nga të cilat pjesa e parë disbursohet fillimisht e plotë.

3.2 Afatet për kërkesën e disbursimit. KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës 30.12.2013.

3.3 Kushtet para disbursimit. KfW-ja është e detyruar të bëjë disbursime të çdo shume sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti me përmushjen e kushteve të mëposhtme paraprake në formë dhe përmbajtje të pranueshme për KfW-në.

a) Huamarrësi do të ketë demonstruar duke paraqitur një opinion ligjor thellësisht në formën e parashikuar në aneksin 2 dhe duke paraqitur kopje të vërtetuara (secila me një përkthim në gjermanisht ose anglisht) të të gjitha dokumenteve të cilave u referohet ky opinion ligjor, që:

aa) Huamarrësi ka përbushur të gjitha kërkesat sipas së drejtës së tij kushtetuese dhe dispozitave të tjera ligjore për përbushjen e vlefshme të të gjitha detyrimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti, dhe

bb) KfW-ja është e përjashtuar nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga interesi, pagesat, tarifat dhe kostot e ngjashme në Shqipëri kur jepet huaja.

b) KfW- ka marrë një kopje të firmosur origjinale të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti.

c) Janë paraqitur ekzemplarët e firmave të përmendura në nenin 13.1 (Përfaqësimi i Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit).

d) Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë, e përmendur në nenin 8 është në fuqi pa kufizim.

e) Huamarrësi ka paguar tarifën e menaxhimit të përmendur në nenin 4.2.

f) Nuk ka ndodhur dhe nuk rrezikon të ndodhë ndonjë shkak për prishje kontrate, sipas parashikimit të nenit 12.

g) Nuk kanë ndodhur rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit, ose përbushjen e detyrimeve të pagesave që merren përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti, dhe

h) Huamarrësi i ka dhënë KfW-së një përkthim të vërtetuar të Marrëveshjes së Kanalizimit të Huasë, të përcaktuar në nenin 2.1.

Para disbursimit nga huaja, KfW-ja ka të drejtën të kërkojë dokumente dhe prova të tjera që i çmon të nevojshme në mënyrë të arsyeshme.

3.4 Marrëveshje e veçantë. Në një marrëveshje të veçantë, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja specifikojnë procedurën e disbursimit që përfshin kushtet specifike paraprake për disbursimin dhe veçanërisht provat që duhet të jepen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, të cilat provojnë se shumat e kërkuara të huasë përdoren për qëllimin e parashikuar në këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti.

3.5 Heqja dorë nga disbursimi. Në pajtim me përbushjen e detyrimeve të tij, sipas nenit 11, Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të huasë me pëlqimin e KfW-së, në këmbim të pagesës së kompensimit të mospranimit, në pajtim me nenin 3.6.

3.6 Kompensimi i mospranimit. Nëse Huamarrësi heq dorë nga disbursimi i një shume huaje, ose nëse një shumë e huasë nuk disbursohet apo nuk disbursohet brenda afatit të përcaktuar në nenin 3.2 për shkaqe të tjera për të cilat KfW-ja nuk mund të mbahet përgjegjëse, Huamarrësi i paguan KfW-së me kërkesë, atë shumë që është e nevojshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzime apo kosto të shkaktuara nga KfW-ja si rezultat i mospranimit të shumës në fjalë të huasë. KfW-ja llogarit shumën e kompensimit të mospranimit dhe ia komunikon atë Huamarrësit.

4. Tarifat

4.1 Tarifa e angazhimit. Huamarrësi paguan një tarifë të pakthyeshme angazhimi deri në 0.25% vjetore mbi shumat e padisbursuara të huasë. Tarifa e angazhimit llogaritet për periudhën që fillon me kalimin e afatit tremujor pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje të Huasë dhe Projektit dhe vazhdon deri në atë datë që huaja është disbursuar plotësisht, ose është anuluar plotësisht, sipas rastit.

Tarifa e angazhimit kërkohet të paguhet çdo gjashtëmujor dhe për vonesat më 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti (secila "Data e pagesës"). Fillimisht duhet të paguhet më 31.06.2010, por jo më parë se data e pagesës pas ditës në të cilën kjo Marrëveshje Huaje dhe Projekti hyn në fuqi, në pajtim me nenin 14.11.

4.2 Tarifa e menaxhimit. Huamarrësi i paguan KfW-së një tarifë menaxhimi të vetme dhe të plotë të barabartë me 1.0% të shumës principale të huasë të parashikuar në nenin 1.1 brenda afatit tre-mujor, pasi kjo Marrëveshje Huaje dhe Projekti të jetë nënshkruar nga KfW-ja ose brenda një afati një-mujor, pasi të ketë hynë në fuqi kjo Marrëveshje Huaje dhe Projektit (në varësi se cila është data e fundit), por në çdo rast para disbursimit të parë nga huaja.

5. Interesi

5.1 Huamarrësi i paguan KfW-së një interes sipas normës së përcaktuar si më poshtë:

a) Interesi (normë fikse interesi e caktuar me bërjen efektive të huasë.) Huamarrësi paguan interes për huanë në një normë të përcaktuar nga KfW-ja me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti sipas nenit 14.11 mbi bazën e kostos faktike të financimit të KfW-së në tregun e kapitalit euro, sipas termave që përputhen më shumë me periudhën e normës fikse të interesit përkatës minus një pjesë prej 0.5% vjetor. ("Normë fikse interesi"). Norma fikse e interesit, e përcaktuar në këtë mënyrë, zbatohet derisa të merret kësti i fundit të shlyerjes, sipas grafikut të shlyerjes sipas parashikimit në nenin 6.1.

b) Njoftimi i normës së interesit. Pesë ditë bankare pasi KfW-ja të jetë informuar që kjo Marrëveshje Huaje dhe Projekti të ketë hyrë në fuqi sipas nenit 14.11, KfW-ja përcakton normën e interesit sipas nenit 5.1 (a) dhe informon përkatësisht Huamarrësin.

5.2 Llogaritja e interesit dhe datat për pagesën e interesit. Interesi për një shumë të disbursuar të huasë paguhet nga llogaria e huasë që mbahet tek KfW-ja për Huamarrësin deri në datën (përfshirë edhe atë), në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së parashikuar në nenin 7.3. Interesi llogaritet në pajtim me nenin 7.1 (Llogaritja). Interesi paguhet në shuma të prapambetura në fund të periudhës në datat e pagesës (sipas përcaktimit në nenin 4.1).

6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 Grafiku i shlyerjes. Huamarrësi do ta shlyejë huanë si më poshtë:

Kësti	Data		Shuma	
1	Qershor 30	2015	1.887.000,00	EURO
2	Dhjetor 30	2015	1.887.000,00	EURO
3	Qershor 30	2016	1.887.000,00	EURO
4	Dhjetor 30	2016	1.887.000,00	EURO
5	Qershor 30	2017	1.887.000,00	EURO
6	Dhjetor 30	2017	1.887.000,00	EURO
7	Qershor 30	2018	1.887.000,00	EURO
8	Dhjetor 30	2018	1.887.000,00	EURO
9	Qershor 30	2019	1.887.000,00	EURO
10	Dhjetor 30	2019	1.887.000,00	EURO
11	Qershor 30	2020	1.888.000,00	EURO
12	Dhjetor 30	2020	1.888.000,00	EURO
13	Qershor 30	2021	1.888.000,00	EURO
14	Dhjetor 30	2021	1.888.000,00	EURO
15	Qershor 30	2022	1.888.000,00	EURO
16	Dhjetor 30	2022	1.888.000,00	EURO
17	Qershor 30	2023	1.888.000,00	EURO
18	Dhjetor 30	2023	1.888.000,00	EURO
19	Qershor 30	2024	1.888.000,00	EURO
20	Dhjetor 30	2024	1.888.000,00	EURO

6.2 Shumat e padisbursuara të huasë. Shumat e padisbursuara të huasë kompensohen me këstin e fundit përkatës që kërkohet, sipas grafikut të shlyerjes, përveç kur KfW-ja, me diskrecionin e saj, zgjedh një alternativë tjetër kompensimi në raste të veçanta.

6.3 Disbursimet pas fillimit të shlyerjes. Nëse shumat e huasë disbursohen pasi të ketë filluar shlyerja, grafiku i shlyerjes i renditur në nenin 6.1 mbetet i pacenuar, nëse kësti përkatës i shlyerjes që kërkohet në pajtim me grafikun e shlyerjes është më i vogël se shumat e huasë që janë disbursuar. Nëse kësti i shlyerjes që kërkohet për t'u paguar e kalon shumën e mbetur të huasë,

KfW-ja zbrit shumën e barabartë me diferencën nga kësti i shlyerjes, e pjesëton atë me pjesën e mbetur të kësteve të shlyerjes të papaguara dhe ia shton këtë shumë çdo kësti të papaguar të shlyerjes. KfW-ja rezervon të drejtën të shtyjë marrjen në konsideratë të disbursimeve që janë bërë brenda 45 ditëve para datës përkatëse të pagesës për përcaktimin e shumës së mbetur të huasë deri në datën e dytë të pagesës pas disbursimit.

6.4 Parapagimi. Sa më poshtë zbatohen për shlyerjet e parakohshme:

a) E drejta për të bërë shlyerje të parakohshme. Huamarrësi, në pajtim me nënparagrafët (b) deri (e) më poshtë, bën një shlyerje të parakohshme në lidhje me një shumë huaje, me kusht që kjo shlyerje e parakohshme të jetë të paktën në shumën e një kësti shlyerjeje në pajtim me nenin 6.1.

b) Njoftimi. Një shlyerje e parakohshme e një shume të huasë, në pajtim me nenin 6.4 (a) i nënshtrohet një njoftimi për shlyerjen nga Huamarrësi kundrejt KfW-së jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë bankare (sipas përkufizimit në nenin 14.1) në Frankfurt am Main para datës së synuar për shlyerjen. Një njoftim i tillë është i parevokueshëm; ai duhet të përcaktojë datën në të cilën duhet të bëhet shlyerja e parakohshme dhe shumë e tij dhe detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e caktuar.

c) Kompensimi i parapagimit. Nëse Huamarrësi shlyen para kohe një shumë huaje që jep interes në një normë fikse interesi, Huamarrësi duhet t'i paguajë menjëherë KfW-së me kërkesë atë shumë që është e nevojshme për të kompensuar çdo humbje, shpenzim ose kosto që shkaktohen nga KfW-ja si rezultat i shlyerjes së parakohshme. KfW-ja përcakton shumën e kompensimit të shlyerjes së parakohshme dhe ia komunikon atë Huamarrësit.

d) Shumat e kërkueshme. Huamarrësi paguan gjithashtu shumat e mëposhtme së bashku me shlyerjen e parakohshme në pajtim me nenin 6.4 (a) deri (c):

aa) çdo kompensim i shlyerjes së parakohshme që kërkohet si rezultat i shlyerjes së parakohshme në pajtim me nenin 6.4 (c); dhe

bb) i gjithë interesi i mbledhur mbi shumën e huasë të shlyer para kohe deri në datën e shlyerjes së parakohshme.

e) Kompensimi. Neni 6.2 (Shumat e padisbursuara të huasë) zbatohet në mënyrë analoge për kompensimin e shlyerjeve të parakohshme.

6.5 Grafiku i rishikuar i shlyerjes. Në rastin kur zbatohet neni 6.3 (Disbursimet pas fillimit të shlyerjes) ose neni 6.4 (Shlyerjet e parakohshme), KfW-ja i dërgon Huamarrësit një grafik të rishikuar për shlyerjen që bëhet pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti dhe zëvendëson grafikun e shlyerjes të vlefshme deri në këtë datë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 Llogaritja. Interesi, tarifa e angazhimit, interesi për mospagim të detyrimeve, në pajtim me nenin 7.5, kompensimi me shumë të plotë për shumat e papaguara në pajtim me nenin 7.6, kompensimi i mospranimit dhe kompensimi i shlyerjes së parakohshme llogariten mbi bazën e një viti me 360 ditë dhe me muaj me 30 ditë.

7.2 Data e kërkueshme. Nëse një pagesë që bëhet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti, bëhet e kërkueshme në një datë që nuk është ditë bankare (sipas përkufizimit në nenin 14.1), Huamarrësi duhet ta bëjë këtë pagesë në ditën bankare pasuese. Nëse dita pasuese bankare bie në muajin kalendarik pasues, pagesa përkatëse bëhet në ditën e fundit bankare të muajit përkatës kalendarik.

7.3 Numri i llogarisë, koha e kreditimit. Huamarrësi detyrohet nga detyrimet e tij për pagesa në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti, nëse menjëherë sapo shumat përkatëse i kreditohen KfW-së në disponimin e saj të lirshëm pa zbritje në euro dhe jo më vonë se ora 10 00 paradite në Frankfurt am Main në llogarinë e KfW-së IBAN DE 09 5002 0400 3102 5608 01 që është e KfW-së, Frankfurt am Main, me referencë shtesë të datës së kërkueshme "Ref. VVVVMMDD".

7.4 Kundërpretendimet e Huamarrësit. Huamarrësi nuk ka të drejtë të ngrejë pretendime për mosdhënien apo kompensimin apo të drejta të ngjashme kundrejt detyrimeve për pagesa sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti, përveç kur këto të drejta njihen me vendim përfundimtar ose nuk kundërshtohen nga KfW-ja.

7.5 Interesi i mospagimit të detyrimeve. Nëse këstet e shlyerjes ose pagesat e parakohshme në pajtim me nenin 6.4 (Pagesa e parakohshme) nuk janë në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa njoftim paraprak, ngarkon një interes të mospagimit të detyrimeve në një normë prej 300 pikë bazë vjetore mbi normën bazë për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe përfundon në datën në të cilën këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së, të përcaktuar në nenin 7.3. Kjo normë duhet të paktën të jetë sa norma e interesit të huasë. “Norma Bazë” është norma e interesit e shpallur nga Banka Qendrore Gjermane (Deutsche Bundesbank) si normë bazë që është në fuqi në datën përkatëse të kërkueshme. Ky interes i mospagimit të detyrimeve duhet të paguhet menjëherë me kërkesën e parë të KfW-së.

7.6 Kompensimi me shumë të plotë. Për shumat e kërkueshme dhe të papaguara (me përjashtim të atyre kësteve të shlyerjes dhe parapagesave, sipas parashikimit në nenin 7.5 (Interesi i mospagimit të detyrimeve) KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë një shumë të përgjithshme me një normë 300 pikë bazë në vit mbi normën bazë që zbatohet në datën përkatëse të kërkueshme për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që mbaron në datën e këtyre shumave të kërkueshme dhe të papaguara. Kompensimi me shumë të plotë duhet të paguhet menjëherë me kërkesën e parë të KfW-së. Huamarrësi është i lirë të vërtetojë që faktikisht nuk është bërë dëm ose që dëmet nuk janë shkaktuar në shumën që deklarohet.

7.7 Kompensimi. KfW-ja ka të drejtën të kompensojë pagesat e marra kundrejt pagesave të kërkueshme, sipas Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit ose sipas marrëveshjeve të tjera të huasë që lidhen ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

7.8 Llogaritja e bëra nga KfW-ja. Përcaktimet e KfW-së me gabime të dukshme dhe llogaritja e shumave, sipas kësaj Marrëveshjeje të Huasë dhe Projektit dhe në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti përbëjnë provë *prima-facie*.

8. Garancia nga Republika Federale Gjermane

KfW-ja ka pretendime pagese në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projektit të garantuara nga Republika Federale Gjermane para disbursimit të parë.

9. Mosndërmarrja e zotimit dhe *pari passu*

9.1 Ndalimi i pengut dhe hipotekës. Huamarrësi nuk mund të rëndojë me peng, hipotekë apo tjetërsojë sendet pasurore të projektit para shlyerjes së plotë të huasë dhe as të lidhë ndonjë marrëveshje tjetër ose marrë masa që kanë si objekt krijimin e një garancie ose një të drejte tjetër që i jep prioritet pagese në lidhje me një detyrim të çdo personi pa pëlqimin paraprak të KfW-së.

9.2 *Pari passu*. Në masën që lejohet nga ligji, Huamarrësi merr përsipër të përbushë detyrime sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projektit *pari passu* me të gjitha detyrimet për pagesë ekzistuese ose të ardhshme të garantuara dhe jo të varura.

10. Kostoja dhe detyrimet publike

10.1 Ndalimet e zbritjeve dhe ndalimeve. Huamarrësi i bën të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projektit pa ndonjë zbritje për tatimet, detyrimet e tjera publike ose kosto të tjera. Në rastin kur huamarrësi është i detyruar me ligj ose për shkaqe të tjera për të bërë çdo zbritje ose ndalim të tillë për pagesat, Huamarrësi i paguan çdo shumë të nevojshme shtesë KfW-së, në mënyrë që shuma neto që mbetet pas çdo ndalimi ose zbritje të përputhet me shumën që do të ishte e pagueshme sipas Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit nëse nuk do të kishte një ndalim apo zbritje të tillë.

10.2 Kostoja. Huamarrësi mbulon të gjitha shpenzimet dhe kostot që shkaktohen në lidhje me disbursimin e huasë, veçanërisht koston e dërgimit dhe transfertës (duke përfshirë tarifat e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që dalin, në lidhje me mbajtjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projektit dhe të gjitha dokumenteve të tjera në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti, si dhe të drejtat që rrjedhin nga kjo Marrëveshje Huaje dhe Projekti.

10.3 Tatimet dhe detyrimet e tjera. Huamarrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që dalin jashtë Republikës Federale Gjermane, në lidhje me lidhjen dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projektit.

10.4 Kostot e rritura. Nëse për shkak të:

a) përmbushjes së kërkesave apo përcaktimeve të nxjerra nga një bankë qendrore ose një autoritet tjetër fiskal, monetar ose tjetër pas datës së kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti,

ose

b) një ndryshim në një ligj ose interpretimin dhe administrimin e tij,

ose

c) hyrja në fuqi, prishja apo ndryshimi i çdo traktati ose marrëveshjeje të zbatueshme bilaterale ose multilaterale, veçanërisht për tatimin e dyfishtë,

KfW-së i lindin kosto shtesë ose humbje apo nuk është në gjendje të përftojë pjesën e rënë dakord tej koston së refinancimit, si rezultat i lidhjes ose financimit të kësaj Marrëveshjeje të Huasë dhe Projektit (“Kostot e Rritura”), KfW-ja njofton për këtë Huamarrësin. Çdo kërkesë e tillë nga KfW-ja shoqërohet nga një njoftim nga KfW-ja që cakton bazën për këtë kërkesë dhe që parashtrohet me hollësi të arsyeshme llogaritjen e shumës përkatëse. Huamarrësi zhdëmton menjëherë KfW-në me kërkesë dhe të gjitha Kostot e Rritura. Neni 7 zbatohet *mutatis mutandis*.

11. Detyrime të veçanta

11.1 Zbatimi i projektit dhe informacioni i veçantë. Agjencia Zbatimit të Projektit:

a) përgatit, zbaton, operon dhe mirëmban projektin në pajtim me praktikatat e qëndrueshme financiare dhe teknike dhe në thelb në pajtim me konceptin e projektit të rënë dakord ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) u cakton përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të projektit inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të pavarur dhe të kualifikuar, dhe zbatimin e projektit firmave të kualifikuara;

c) u jep kontratat për mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja me ofertim paraprak konkurrues ndërkombëtar;

d) mban librat dhe regjistrat ose porositi mbajtjen e librave dhe regjistrave që tregojnë qartë kostot e mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për projektin dhe identifikon qartë mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja;

e) u mundëson përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë të inspektojnë këto libra dhe regjistra dhe çdo dokumentacion tjetër të rëndësishëm për zbatimin dhe operimin e projektit, dhe të vizitojnë projektin dhe të gjitha instalimet në lidhje me të;

f) i jep KfW-së çdo informacion dhe të dhëna të tjera për projektin dhe progresin e mëtejshëm siç kërkohet nga KfW-ja;

g) menjëherë dhe me iniciativë të saj, njofton KfW-në për çdo rrethanë që pengon ose rrezikon seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit;

h) i jep KfW-së çdo informacion mbi gjendjen e tij financiare siç kërkohet nga KfW-ja;

i) i dërgon KfW-së, sa më shpejt që të jetë e mundur, në çdo rast brenda gjashtë muajve pas fundit të vitit financiar, pasqyrat financiare me bilancet dhe llogaritë e fitimeve dhe humbjeve dhe shënimet përkatëse që auditohen në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportimin Financiar (IFRS) nga një audit i njohur ndërkombëtarisht dhe i pavarur; dhe

j) u mundëson përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrat që duhet të reflektojnë aktivitetin e punës dhe gjendjen financiare të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, në pajtim me parimet standarde të kontabilitetit.

11.2 Marrëveshje e Veçantë. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e nenit 11.1 me marrëveshje të veçantë që miratohet nga Huamarrësi.

11.3 Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) sigurojnë financimin e plotë të projektit dhe, me kërkesë, i paraqesin KfW-së prova që provojnë se kostoja që nuk mbulohet nga kjo hua është e mbuluar;

b) njoftojnë me iniciativë të tyre menjëherë KfW-në për (i) ndodhinë ose ndodhinë e mundshme të një Ngjarjeje të Qenies në Vonesë dhe (ii) për çdo ose të gjitha rrethanat që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit; dhe

c) i paraqesin KfW-së çdo kërkesë që merret nga Agjencia e Zbatimit të Projektit prej OECD-së ose anëtarëve të saj, sipas “Marrëveshjes për Transparencën e Kredive të Palidhura ODA” pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga huaja dhe bashkërendojnë përgjigjen për çdo kërkesë të tillë me KfW-në.

11.4 Huamarrësi ndihmon Agjencinë e Zbatimit të Projektit në pajtim me praktikat e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e projektit dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti dhe, veçanërisht, i jep Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit.

11.5 Përputhshmëria. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit sigurojnë që personat të cilëve ata u besojnë përgatitjen dhe zbatimin e projektit, dhënien e kontratës për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen dhe me kërkesën e shumave të huasë nuk kërkojnë, pranojnë, bëjnë, ofrojnë premtojnë apo marrin premtime të pagesave të paligjshme ose avantazhe në lidhje me këto detyra.

11.6 Transporti i mallrave. Dispozitat e parashikuara në Marrëveshjen Qeveritare që janë të njohura për Huamarrësin dhe Agjencinë e Zbatimit të Projektit zbatohen për transportin e mallrave që financohen nga huaja.

12. Prishja e marrëveshjes

12.1 Ngjarjet e mospërmbushjes së detyrimeve. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e parashikuara sipas nenit 12.2 (Pasojat ligjore të një ngjarjeje të mospërmbushjes së detyrimeve) nëse ndodh një ngjarje që përbën shkak material (*wichtiger Grund*). Në veçanti, secila nga ngjarjet e mëposhtme përbën një shkak material:

a) Huamarrësi nuk përmbush detyrimet kundrejt KfW-së për të bërë pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti ose me marrëveshje të veçanta që i përkasin kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti janë shkelur nga Huamarrësi dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit;

c) kjo Marrëveshje Huaje dhe Projekti ose një pjesë e saj pushon pasjen e një efekti detyrues mbi Huamarrësin dhe/ose Agjencinë e Zbatimit të Projektit ose pushon së qeni e zbatueshme kundrejt Huamarrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit;

d) çdo deklaram, konfirmim, informacion ose përfaqësim apo garanci që konsiderohet nga KfW-ja të jetë thelbësor për dhënien ose mbajtjen e huasë del i rremë, i gabuar ose i paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që shtyjnë ose pengojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti; ose

f) një nga ngjarjet e mëposhtme ndodh në lidhje me Huamarrësin:

aa) Huamarrësi, sipas ligjit të zbatuar, është në paaftësi paguese, i falimentuar ose jo në gjendje për të paguar borxhet, kur bëhen të kërkueshme (ose që konsiderohen të tilla sipas ligjit të zbatueshëm);

bb) fillimi i negociatave me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit (me përjashtim të KfW-së) mbi heqjen dorë nga detyrimet e papaguara ose shtyrjen e pagesës ose për një pezullim apo zgjidhje tjetër.

12.2 Pasojat ligjore të ngjarjes së mospërmbushjes së detyrimeve. Nëse ka ndodhur një nga ngjarjet e përmendura në nenin 12.1 dhe nuk është eliminuar brenda një afati prej pesë ditësh (në rastin e nenit 12.1 (a) ose, në të gjitha rastet e tjera të përcaktuara në nenin 12.1, nuk është zgjidhur brenda një afati të përcaktuar nga KfW-ja që nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, KfW-ja mund ta prishë këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti ose pjesë të saj, me pasojën që:

a) detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti mbarojnë, dhe

b) KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e plotë ose të pjesshme të shumës së mbetur të huasë me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera që janë të kërkueshme, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti. Nenit 7.5 (Interesi i mospagimit të detyrimeve) dhe 7.6 (Kompensimi me shumë të plotë) zbatohen për shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

12.3 Kompensimi i dëmeve. Në rastin kur kjo Marrëveshje Huaje dhe Projekti prishet plotësisht ose pjesërisht, Huamarrësi paguan kompensimin e mospranimit në pajtim me nenin 3.6 (Kompensimi i mospranimit) dhe/ose kompensimin e parapagimit në pajtim me nenin 6.4 (c) (Kompensimi i shlyerjes së parakohshme).

13. Përfaqësimi dhe deklaramet

13.1 Përfaqësimi i Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Ministri i Financave dhe ata persona të tjerë që përcaktohen prej tij ose prej saj për KfW-në dhe të autorizuar nga 1324

ekzemplarët e firmave të vërtetuara prej tij ose saj përfaqëson Huamarrësin në nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe persona të tjerë që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nga ekzemplarët e firmave të vërtetuara prej tij ose saj përfaqësojnë Agjencinë Zbatuese të Projektit në nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti. Fuqitë e përfaqësimit nuk skadojnë deri sa të merret nga KfW-ja revokimi i shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar i kohës.

13.2 Adresat. Njoftimet ose deklaratimet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen me kopje origjinale ose – me përjashtim të kërkesave për disbursime – me faks. Të gjitha njoftimet dhe deklaratimet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: KfW
Department L III a 3
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main / Germany
Germany
Fax: +49 69 7431-2944

Për Huamarrësin: Ministria e Financave
Blv. "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë
Shqipëri
Tel: +355 4 2228405
Fax: +355 4 2228494

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.
Bulevardi "Gjergj Fishta", nr. 10
Tiranë
Albania
Tel: +355 4 2225581
Fax: +355 4 2225581

14. Dispozita të përgjithshme

14.1 Ditë bankare. Nëse bëhet referencë në këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti të një "Ditë Bankare", kjo do të thotë një ditë e ndryshme nga një e shtunë ose e diel në të cilën bankat tregtare në Frankfurt am Main janë të hapura për punën e zakonshme.

14.2 Vendi i përmbushjes së detyrimeve. Vendi i përmbushjes së të gjitha detyrimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti është Frankfurt am Main, Republika Federale Gjermane.

14.3 Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti është ose bëhet e pavlefshme, apo nëse ka një boshllëk në një prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti, kjo nuk ndikon mbi vlefshmërinë e dispozitave të tjera të saj. Palët në këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një të vlefshme që afrohet sa më shumë të jetë e mundur me frymën dhe qëllimin e dispozitës së pavlefshme. Palët mbushin çdo boshllëk në dispozitat me një dispozitë ligjërisht të vlefshme që afrohet sa më shumë të jetë e mundur me frymën dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti.

14.4 Forma e shkruar dhe ndryshimet. Ndryshimet dhe shtesat në këtë kontratë duhet të jenë me shkrim. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë e formës shkresore duhet të deklarohet nga palët me shkrim. Ndryshimet në këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti që ndikojnë vetëm mbi raportin ligjor ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit nuk kërkojnë aprovimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

14.5 Transferimi. Huamarrësi nuk mund të transferojë, rëndojë me peng ose hipotekë asnjë pretendim nga kjo Marrëveshje Huaje dhe Projekti.

14.6 Ligji i zbatueshëm. Marrëveshja e Huasë dhe Projektit rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane.

14.7 Periudha e parashkrimit. Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti skadojnë pesë vjet nga fundi i vitit në të cilin kanë lindur këto pretendime dhe ku KfW-ja ka marrë dënim për rrethanat që kanë shkaktuar pretendimin ose mund të ishte vënë në dënim pa neglizhencë të dukshme.

14.8 Heqja dorë nga imuniteti. Në masën që Huamarrësi në të tashmen ose të ardhmen në një juridiksion mund të pretendojë për vete ose sendet pasurore të tij imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi apo proces tjetër ligjor dhe në masën që në një juridiksion të tillë mund t'i vishet atij vetë ose sendeve ky imunitet, Huamarrësi bie dakord, në mënyrë të pakthyeshme, për të mos pretenduar dhe heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga ky imunitet në masën më të gjerë që lejohet nga ligjet e këtij juridiksioni.

14.9 Mosmarrëveshjet ligjore - Arbitrazhi. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga kjo ose në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht me gjykatë arbitrazhi. Në këtë kuptim, zbatohet sa më poshtë:

a) gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre gjyqtarë arbitrazhi që emërohen dhe vepronë në pajtim me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC), e cila ndryshohet herë pas here.

b) Gjykimet në arbitrazh zhvillohen në Frankfurt am Main. Gjykimi mbahet në gjuhën angleze.

14.10 Transmetimi i informacionit. KfW-ja ka të drejtë t'i transmetojë dhënësit të garancisë federale, të përmendur në nenin 8 dhe Republikës Federale Gjermane informacion mbi lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti. KfW-ja, dhënësi i garancisë federale, dhe Republika Federale Gjermane kanë të drejtën të kalojnë informacion në lidhje me huanë dhe projektin duke përfshirë dhënien e kontratave për furnitorët dhe shërbimet që financohen nga huaja organizatave ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore, veçanërisht në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me shërbimin e borxhit dhe/ose mbledhjen dhe publikimin e të dhënave në lidhje me dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga huaja. E drejta e mësipërme për dhënien e informacionit organizatave ndërkombëtare përfshin edhe të drejtën për të kaluar informacion drejtpërdrejt tek anëtarët e këtyre organizatave.

14.11 Hyrja në fuqi. Kjo Marrëveshje Huaje dhe Projekti hyn në fuqi vetëm pasi të kenë hyrë në fuqi (i) Marrëveshja Qeveritare ku ajo bazohet dhe (ii) Marrëveshjet Plotësuese të Huasë.

Kjo Marrëveshje Huaje dhe Projekti përpilohet në tre kopje origjinale në gjuhën angleze.

Tiranë, dhjetor 2009

.....

KfW

.....
Republika e Shqipërisë
përfaqësuar nga Ministria e Financave,
përfaqësuar nga Ministri

.....
Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm

Grafiku i disbursimit

Në fund të çdo periudhe që tregohet më poshtë, Huamarrësi do të ketë kërkuar disbursimin e shumave të huasë që nuk kalon në total shumën e treguar më poshtë për secilën periudhë.

Të gjitha shifrat në euro	Disbursuar në këtë periudhë	Disbursuar në periudhat e mëparshme	Disbursimet e përgjithshme
Gjysma e vitit që mbaron në 30 qershor 2010	377 500	0	377 500
Gjysma e vitit që mbaron në 30 dhjetor 2010	7 550 000	377 500	7 927 500
Gjysma e vitit që mbaron në 30 qershor 2011	7 550 000	7 927 500	15 477 500
Gjysma e vitit që mbaron në 30 dhjetor 2011	7 550 000	15 477 500	23 027 500
Gjysma e vitit që mbaron në 30 qershor 2012	5 662 500	23 027 500	28 690 000
Gjysma e vitit që mbaron në 30 dhjetor 2012	5 662 500	28 690 000	24 352 500
Gjysma e vitit që mbaron në 30 qershor 2013	3 397 500	34 352 500	37 750 000

Forma e opinionit ligjor të këshilltarit ligjor të Huamarrësit (shteti)

[Koka e letrës së këshilltarit ligjor]

KfW
(datë)
Department L IIIa3
Attn: Dr. Jens Drillisch
Palmengartenstrasse 5 - 9
Postfach 11 11 41
60325 Frankfurt am Main / Germany

Republika Federale Gjermane

Marrëveshje e Huasë dhe Projektit e lidhur ndërmjet KfW, (.....) (“Huamarrësi”) dhe (.....) për një shumë që nuk kalon një shumë të përgjithshme prej 37 750 000 euro.

Të nderuar zotërinj,

Unë jam (Ministri i Drejtësisë) (këshilltari ligjor) (kreu i departamentit ligjor të (jeni të lutur të specifikoni ministrinë ose autoritetin tjetër) të) Republika e Shqipërisë. Unë kam vepruar në këtë cilësi në lidhje me Marrëveshjen e Huasë dhe të Projektit (“Marrëveshja e Huasë dhe Projektit”), datë . . . , dhe të lidhur ndërmjet Huamarrësit, (. . .) dhe jush në lidhje me një hua që i jepet prej jush Huamarrësit në një shumë që nuk kalon në total 37 750 000 euro.

1. Dokumentet e shqyrtuara

Unë kam shqyrtuar:

1.1 një kopje origjinale të nënshkruar të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit;

1.2 dokumentet kushtetuese të Huamarrësit, veçanërisht:

a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të datës , publikuar rregullisht më , nr. , faqe. , të ndryshuar;

b) Ligjet nr datë , publikuar rregullisht më , nr. , faqe. , të ndryshuar (jeni të lutur të përfshini këtu, sipas rastit, ligjet (p.sh. ligjet e buxhetit) në lidhje me huamarrjen e parave nga Republika e Shqipërisë);

c) (jeni të lutur t’u referoheni dokumenteve të tjera, p.sh. dekretive ose rezolutave të organeve qeveritare dhe administrative të Shqipërisë mbi lidhjen e marrëveshjeve të huasë nga Shqipëria në përgjithësi ose mbi përfundimin e Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit); dhe

d) Marrëveshjen e Bashkëpunimit Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale Gjermane të datës (“Marrëveshja e Bashkëpunimit”) dhe ato ligje, rregullore, certifikata, regjistra, regjistrime dhe dokumente dhe që janë bërë ato hetime që unë i kam çmuar të nevojshme ose të dëshirueshme për qëllimin e dhënies së këtij opinionit.

2. Mendimi

Për qëllimet e nenit të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit, unë jam i mendimit që në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë në këtë datë:

2.1 Në pajtim me nenin të Kushtetutës / neni të ligjit mbi (jeni të lutur të specifikoni siç duhet) Huamarrësi ka të drejtën të lidhë Marrëveshje Huaje dhe Projekti dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin, dhënien dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit, veçanërisht në mbështetje të:

a) Ligjit(eve) nr datë të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë, që ratifikon Marrëveshjen e Huasë dhe Projektit / që aprovon lidhjen, dhënien dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit me Huamarrësin / (jeni të lutur të përfshini sipas rastit);

2.7 Huamarrja nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit dhe nënshkrimi dhe përmbushja nga Huamarrësi i Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit përbëjnë akte private dhe tregtare dhe nuk janë akte qeveritare apo publike. As Huamarrësi dhe asnjë nga pasuritë e tij nuk e ka të drejtën e imunitetit ndaj arbitrazhit, padisë, ekzekutimit, sequestrimit ose procesi tjetër ligjor.

2.8 Marrëveshja e bashkëpunimit është plotësisht në fuqi në bazë të kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë. (Në pajtim me nenin 3 të marrëveshjes së bashkëpunimit) (Nëse marrëveshja e bashkëpunimit nuk ka hyrë në fuqi, por nuk ekziston një marrëveshje e tatimit të dyfishtë) Në pajtim me

(jeni të lutur të specifikoni traktatin ose ligjet dhe rregulloret e zbatueshme). Huamarrësi nuk kërkohet të bëjë zbritje apo ndalesa nga ndonjë pagesë që Huamarrësi duhet të bëjë sipas Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit dhe nëse një ndalesë ose zbritje duhet të zbatohet më vonë, dispozitat e nenit 11.1 të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit zbatohen për të kërkuar që Huamarrësi të zhdëmtojë KfW-në përkatësisht.

2.9 KfW-ja nuk është dhe nuk mendohet të jetë rezident, me banim, të zhvillojë biznes ose t'i nënshtrohet tatimit në Shqipëri vetëm për shkak të nënshkrimit, përmbushjes ose zbatimit të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit. Nuk është e nevojshme që KfW-ja të licencohet, kualifikohet ose të marrë të drejta të tjera për të zhvilluar biznes ose që KfW-ja të emërojë agjentë apo përfaqësues në Republikën e Shqipërisë.

Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta dhe pa kushte të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin që janë të ekzekutueshme ndaj Huamarrësit në pajtim me termat e tyre përkatës.

Ky opinion ligjor është i kufizuar te ligjet e Republikës së Shqipërisë.

.....
(vendi) (datë)

(Firmë)

Emri:

Bashkëlidhur:

Shënim. Jeni të lutur të bashkëlidhni fotokopje të vërtetuara të dokumenteve dhe dispozita ligjore të përmendura më sipër sipas seksionit 1.2 (a) deri 1.2 (c) dhe seksioneve 2.1 deri 2.3 dhe 2.8 (duke marrë parasysh ligjet me gjatësi të konsiderueshme dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, një kopje të dispozitave përkatëse do të ishte e mjaftueshme) dhe jepini KfW-së një përkthim të vërtetuar në anglisht ose gjermanisht të dokumenteve të sipërpërmendur nëse këto dokumente nuk janë lëshuar në anglisht ose gjermanisht si gjuhë zyrtare.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.
Bulevardi "Gjergj Fishta", nr. 10
Tiranë
Shqipëri

Dr. Jens Drillisch
Tona.: DJ
Tel: ++49 69 7431-9705
email: jens.drillisch@KfW.de
Datë: dhjetor 2009

L III a3 Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
37 750,000 EUR
Nr. BMZ: 2008.65.188
Marrëveshje e Veçantë për Marrëveshjen e Huasë dhe të Projektit të datës dhjetor 2009

Të nderuar zotërinj,

Në pajtim me Marrëveshjen e Huasë dhe të Projektit të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, ("Huamarrësi") dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. ("Agjencia Zbatuese e Projektit") dhe KfW-së ("KfW") të datës ____ dhjetor 2009 sa më poshtë, përcaktohet me marrëveshje të veçantë:

Në pajtim me nenin 1.2:

hollësitë e projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja;

Në pajtim me nenin 3.1:

procedura e disbursimit, veçanërisht provat që provojnë se shumtat e disbursuara të huasë përdoren për qëllimin e parashikuar;

Në pajtim me nenin 11.2:

hollësitë që i përkasin nenit 11.1 (Zbatimi i projektit dhe informacioni i veçantë).

Ne propozojmë që të bihet dakord për sa më poshtë:

I. Plani i projektit

1. Hollësitë e projektit

Projekti ka të bëjë me ndërtimin e Linjës Unazore 110-kV të Shqipërisë së Jugut. Qëllimi i projektit është përmirësimi i furnizimit sasior dhe cilësor me energji elektrike në Shqipërinë e Jugut dhe reduktimi i dëmtimit global dhe lokal i ambientit. Kjo kontribuon në forcimin e një zhvillimi të qëndrueshëm në Shqipërinë e Jugut dhe për mbrojtjen klimaterike. Kriteret për arritjen e këtyre objektivave, rezultatet e projektit dhe aktivitetet e kërkuara të projektit, si dhe përgjegjësitë mbi të cilat mbështetet qëllimi i projektit gjenden në aneksin 1.

Plani i projektit është bazuar në studimet e parafizibilitetit "Projekti i transmetimit të energjisë në Jug-Lindje" dhe "Projekti i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë në Jug-Perëndim" nga marsi i vitit 2006 që i janë dhënë KfW-së, Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe mbi marrëveshjet e lidhura ndërmjet KfW-së, Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit gjatë vlerësimit të projektit lokal.

Aktivitetet e mëposhtme të projektit financohen nga huaja: një linjë e re 110-kV nga Babica në Sarandë, fuqizimi i nënstacioneve në Babicë dhe Sarandë, lidhjet 110-kV të Orikutit dhe Himarës me linjën e porsandërtuar 110-kV nga Ersekë – Përmet, Korçë – Ersekë dhe Përmet – Këlcyrë – Memaliaj; fuqizimin e nënstacioneve në Përmet, Ersekë, Korçë, Këlcyrë dhe Memaliaj, fuqizimin e nënstacionit të Zemblakut, dhe ndërtimin e një linje 110-kV Zemblak-Korçë. Sipas rastit, fondet e mbetura përdoren për investimet e nevojshme në pajisjet e tensionit të lartë.

2. Grafiku kohor

Grafiku kohor përkatës për përgatitjen, zbatimin dhe operimin e projektit gjendet në aneksin 2.

3. Kostoja e përgjithshme dhe financimi

Kostoja e përgjithshme e parashikuar e projektit ("Kostoja e përgjithshme") ku mbështetet vlerësimi i projektit është afërsisht 51 700 000 euro. Shuma e huasë është 49 000 000 euro.

Huaja jepet në bazë të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit deri në 37 750 000 euro si pjesë përbërëse e një pakete për të financuar projektin "Linja Unazore 110-kV e Jugut të Shqipërisë". Dy hua shtesë duhet të jepen nga KfW-ja në një shumë deri në 10 750 000 euro dhe në një shumë deri në 500,000 euro sipas dy marrëveshjeve të veçanta huaje dhe projekti ndërmjet KfW-së, Huamarrësit dhe Agjencisë Zbatuese të Projektit ("Marrëveshje Plotësuese të Huasë") me shtesë të paketës si pjesë përbërëse (kjo Marrëveshje e Huasë dhe Projektit dhe Marrëveshjet Plotësuese të Huasë së bashku "Marrëveshjet e Huasë").

Përbërja e kostos së përgjithshme dhe plani i financimit gjenden në aneksin 3. Për disbursimet e shumës së huasë shihni aneksin 6.

4. Ndryshimet në planin e projektit

Çdo ndryshim i konsiderueshëm në planprojekt kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së. Agjencia e Zbatimit të Projektit informon KfW-në për këtë menjëherë, duke deklaruar shkaqet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimeve (duke përfshirë koston e përgjithshme). Zbatimi i këtyre masave fillon vetëm mbi bazën e planit të rishikimit dhe me pëlqimin e KfW-së.

II. Zbatimi i projektit

1. Përgjegjësitë dhe koha, kostoja dhe grafiku i financimit

1.1 Agjencia Zbatuese e Projektit është përgjegjëse për zbatimin e projektit. Agjencia e Zbatimit të Projektit ngre një njësi të veçantë për zbatimin e projektit (PIU), që ngrihet dhe është përgjegjëse për zbatimin e projektit deri në pranimin përfundimtar.

1.2 Afatet, kostoja e detajuar dhe grafiku i financimit, i përditësuar rregullisht për zbatimin e përshtatshëm teknik dhe financiar të projektit, përgatiten sa më shpejt të jetë e mundur nga Agjencia Zbatuese e Projektit në bashkëpunim me konsulentin dhe i paraqitet KfW-së. Ky grafik tregon, me afate dhe shuma, ndërlidhjen e parashikuar kronologjike të aktiviteteve të projektit dhe kërkesat përkatëse financiare. Nëse një shmangie nga ky grafik bëhet i nevojshëm gjatë zbatimit të projektit, KfW-së dhe Huamarrësit i jepet një grafik i rishikuar.

2. Caktimi i një konsulenti

2.1 Detyrat e konsulentit përbëhen nga:

Faza 1a: Faza para planifikimit:

a) Rishikimi i konceptit teknik, mbledhja e të dhënave dhe rishikimi i të gjitha të dhënave të disponueshme, informacioni dhe planet në lidhje me nënstacionet ekzistuese dhe të planifikuar 110-kV (diagramat, planet e ndërtimit, dokumentet planifikuese dhe skicat e hollësishme të impianteve) dhe linjat e planifikuara të transmetimit 110-kV, si dhe impiantet e tjera të kërkuara/ekzistuese të përshkruara në kapitullin 1.3 të këtyre termave.

b) Rindërtimi i skicave që mungojnë të cilat kërkohen për zbatimin e projektit dhe përgatitjen e kopjeve të riprodhueshme.

c) Shqyrtimi i gjendjes teknike të impianteve ekzistuese dhe përgatitja e një vështrimi të përgjithshëm të këtyre impianteve dhe strukturave që duhet të mbahen.

d) Asistenca për OST-në në drejtimin e linjës 110-kV duke përfshirë vendndodhjen e kullave të këndeve dhe kabllave ushqyese shtesë në nënstacionet ekzistuese dhe pajisjet e tjera.

e) Specifikimet e masave të projektit, duke marrë parasysh çdo ndryshim që mund të ketë ndodhur.

f) Përgatitja e planifikimit paraprak dhe grafiku kohor i furnizimeve dhe shërbimeve, d.m.th. paraqitja e një raporti të planprojektit që duhet të përpilohet në mënyrë të tillë që mund të përdoret (të paktën pjesërisht) drejtpërdrejt për qëllime tenderimi.

g) Rishikimi i llogaritjes së koston dhe përditësimi i parashikimit të koston së investimeve, bazuar në informacionin më të fundit që disponohet.

h) Mbështetja e PIU-t në procesin e marrjes së lejeve dhe licencave të kërkuara.

i) Konsulenca për Agjencinë Zbatuese të Projektit në lidhje me sigurimin e të drejtave të përdorimit të rrugës dhe tokës, si dhe kompensimet e paguara nga Agjencia e Zbatimit të Projektit (sipas rastit).

j) Mbështetja e PIU-t në përpilimin e një vlerësimi të impaktit mjedisor në pajtim me kërkesat shqiptare dhe standardet ndërkombëtare për të marrë lejen për ndërtimin e linjave ajrore dhe artikuj të tjerë nga autoritetet përkatëse (sipas rastit).

k) Së bashku me PIU-n: përpilimi i konceptit të zbatimit dhe grafiku i zbatimit dhe grafiku i koston dhe financimit për programin.

Faza 1b: Rishikimi dhe përgatitja e tenderit, procedura e tenderit

l) Në bashkëpunim me PIU-n: rishikimi dhe ndryshimi, sipas rastit, i dokumenteve të tenderit për mallrat dhe shërbimet, duke përfshirë termat dhe kushtet standarde për tenderat, preventivat, përshkrimin teknik të pajisjeve dhe impianteve dhe një projektkontratë të furnizimit dhe punëve mbi bazën e rregulloreve FIDIC.

m) Mbështetje për PIU-n gjatë periudhës së tenderit për të asistuar në përzgjedhjen e kontraktorit të përgjithshëm, duke përfshirë njoftimin për tender, organizimin e një vizite të

detyrueshme në vend, përgjigjet për pyetjet mbi tenderin, pjesëmarrjen në hapjen e tenderit, përpilimin e protokollit të hapjes së tenderit dhe shërbime të tjera për procedurën e tenderit, në pajtim me kuadrin ligjor në Shqipëri.

n) Bashkëpunim me PIU-n si drejtuese e vlerësimit të tenderit, përgatitja e raportit të vlerësimit të ofertës dhe paraqitja e tij tek PEA dhe KfW-ja.

o) Formulimi i njoftimit për rekomandimin e dhënies së kontratës.

p) Mbështetja e PEA-s për lidhjen e kontratës së furnizimit dhe punëve me kontraktorin e përgjithshëm.

q) Mbështetja e PEA-s në përgatitjen e raportit përfundimtar të vlerësimit.

Faza 2: Auditimi teknik dhe mbikëqyrja e vendit, përfundimi i projektit

r) Organizimi i një takimi prezantues me aktorët përkatës dhe autoritetet gjatë të cilit duhet të prezantohet projekti.

s) Organizimi i takime periodike koordinuese me klientin dhe kontraktorin dhe raporti në këto mbledhje, sipas rastit dhe në pajtim me formatin e rënë dakord.

t) Monitorimi i respektimi rigoroz nga kontraktori i afatit të ndërtimit që është miratuar.

u) Këshillimi i OST-së për të dhënë lejet dhe të drejtat e rrugës që kërkohen nga kontraktori që të respektohet grafiku kohor i miratuar.

v) Miratimi i planprojekteve dhe pjesëmarrja në testet e pranimit të fabrikimit të pajisjeve në pajtim me rregulloret e miratuara dhe standardet dhe veprimet diskrecionare të zakonshme bazuar në eksperiencën profesionale.

w) Mbikëqyrja e cilësisë së punëve të ndërtimit dhe instalimit, si dhe të furnizimeve dhe shërbimeve të kontraktorit të përgjithshëm nëpërmjet një përfaqësimi të përshtatshëm në vend.

x) Përgatitja e një planprojekti të hollësishëm për ndërlidhjen e pajisjeve të reja elektrike me pajisjet elektrike ekzistuese. Përgatitja e kushteve dhe kriterëve për ndërlidhjen, me specififikimet, llogaritjet, diagramet, skemat dhe skicat për pajisjet që ndërlidhen drejtpërdrejt. Mbikëqyrja e punëve të çmontimit dhe prishjes në lidhje me rikonfigurimin e rrjetit, sipas rastit.

y) Asistenca në mbikëqyrjen e kostos së projektit dhe shqyrtimi i faturave të kontraktorit të përgjithshëm.

z) Monitorimi i programit të trajnimit nga personeli i PEA/PIU-t.

aa) Mbështetja e PEA/PIU-t në përpilimin e një koncepti të operacioneve dhe mirëmbajtjes.

bb) Asistenca në monitorimin dhe autorizimin dhe fillimin e operimit tregtar.

cc) Komenti dhe mbikëqyrja e aktiviteteve trajnuese, që kontraktori duhet të japë për personelin e OST-së brenda objektit të kontratës.

dd) Asistenca e OST-së në përgatitjen e raporteve semestrare mbi zbatimin e projektit, duke përfshirë përshkrimet e vështirësive që kanë dalë dhe masat që duhet të merren për zgjidhjen e këtyre vështirësive.

ee) Shërbimet e rastësishme dhe të parashikuara të konsulencës gjatë “periudhës së përgjegjësive së defekteve” të pajisjeve të energjisë elektrike (Punët).

ff) Asistenca e OST-së në përpilimin e një raporti vlerësimi në lidhje me zbatimin e projektit.

Për hollësitë e shërbimeve të konsulencës, shihni kontratën e konsulencës së nënshkruar.

2.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit ka caktuar konsulentin Fichtner GmbH&Co. KG me ofertë ndërkombëtare publike, konkurruese, me kontratën që është nënshkruar më 29 shtator 2009. Faza 1 e kontratës me konsulentin përbën planifikimin e detajuar dhe asistencën në tenderimin e mallrave dhe shërbimeve dhe financohet nga fondet shtesë të grantit të një fondi të veçantë të Qeverisë Gjermane. Faza 2 (mbikëqyrja e zbatimit të punëve dhe përfundimit të projektit) është kontraktuar si opsion dhe hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit në këtë Marrëveshje të Veçantë. Faza 2 do të financohet në kuadrin e Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit.

2.3 Në rast se zgjidhet një konsulent tjetër, pas ofertimit paraparak dhe ndërkombëtar publik konkurrues, kontrata i jepet një konsulenti të pavarur të kualifikuar. Procedura e dhënies së kontratës rregullohet nga “Udhëzimet për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim” (aneksi 4), që përbën pjesë integrale të kësaj.

2.4 Nëse është i nevojshëm, në njoftimin parakualifikues – ose nëse nuk ka njoftim parakualifikues – në ftesën për tender, Agjencia e Zbatimit të Projektit detyron ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e ofertës ose së bashku me ofertën deklarimin e sipërmarrjes të nënshkruar rregullisht (aneksi 4, faqe 16).

2.5 Nëse është e nevojshme, KfW-ja asiston Agjencinë e Zbatimit të Projektit në përzgjedhjen e konsulentit dhe dhënien e kontratës dhe gjatë dhënies së shërbimeve të konsulencës. Hollësitë përcaktohen në një kontratë të veçantë me agjencinë.

3. Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet

3.1 Kontratat për mallrat dhe të gjitha shërbimet e tjera jepet në bashkëpunim me konsulentin dhe me ofertë ndërkombëtare konkurruese.

3.2 Dokumentet e tenderit i paraqiten KfW-së për komente dhe dhënien e moskundërshtimit në kohën e duhur para publikimit të ftesës për tender.

3.3 Afati i tenderit përcaktohet në një mënyrë që u jep ofertuesve kohën e mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.4 Hollësitë e mëtejshme në lidhje me procedurën e dhënies dhe dispozitat kontraktuale shpjegohen në “Udhëzimet për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punëve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim” (aneksi 5), që përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

3.5 Në njoftimin e parakualifikimit ose – nëse nuk zhvillohet parakualifikim – në dokumentet e tenderit, Agjencia e Zbatimit të Projektit i detyron ofertuesit për të paraqitur së bashku me dokumentet e parakualifikimit ose së bashku me ofertën një deklaratë sipërmarrjeje (aneksi 5, faqe 27).

3.6 Gjatë lidhjes së kontratave për mallra dhe shërbime që financohen nga huaja, Agjencia e Zbatimit të Projektit respekton gjithashtu parimet e mëposhtme:

a) Meqenëse asnjë tarifë importi nuk financohet nga huaja në pajtim me nenin 1.3 të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit, këto tarifa importi, nëse janë pjesë e vlerës së kontratës, shprehen veçmas në kontratat për mallrat dhe shërbimet dhe në fatura.

b) Nëse është në pajtim me legjislacionin shqiptar, zbatohet sa më poshtë: nëse pagesat e kërkueshme sipas kontratave të mallrave dhe shërbimeve duhet të bëhen nga huaja, këto kontrata përfshijnë një dispozitë që parashikojnë që çdo riimbursim, garanci ose pagesë tjetër e kërkueshme e ngjashme dhe çdo pagesë siguracioni bëhen për llogari të Agjencisë së Zbatimit të Projektit në llogarinë nr. 38 000 000 00 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00) në KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), ku KfW-ja krediton këto pagesa në llogarinë e Huamarrësit. Nëse këto pagesa bëhen në monedhën lokale, ato dërgohen në një llogari të veçantë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit në vendin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit, që mund të tërhiqet vetëm me pëlqimin e KfW-së. Këto fonde mund të realizohen për zbatimin e projektit me pëlqimin e KfW-së.

3.7 Para lidhjes së kontratës për mallrat dhe shërbimet, KfW-së i paraqitet për mendim projekt kontrata siç është rënë dakord, e paraqitur rregullisht me pëlqimin e konsulentëve. Kjo zbatohet edhe për çdo marrëveshje të mëvonshme ndryshuese ose modifikuese.

4. Marrëveshjet e veçanta të zbatimit

4.1 OST do të përftojë të drejtat e përdorimit të rrugës dhe të tokës të nevojshme për masat e ndërtimit (ngritja e shtyllave të tensionit të lartë, si dhe ndërtesat për mekanizmat e thikave) nga pronarët/zotëruesit sipas një procedure në pajtim me të drejtën shqiptare dhe do të paguajë menjëherë të gjitha zhdëmtimet e nevojshme për palët e prekura. Konsulenti do të këshillojë OST-në sipas rastit dhe do t'i raportojë KfW-së në lidhje me respektimin e rregullt të ligjit.

4.2 Gjatë zbatimit të projektit, Agjencia e Zbatimit të Projektit do të kryejë një studim të impaktit mjedisor mbi bazën e kuadrit rregullues përkatës shqiptar dhe rregulloreve të BE-së dhe do të zbatojë projektin në këtë kuadër. Në rast se standardet e brendshme devijojnë në thelb nga rregulloret e BE-së dhe këto devijime kanë një ndikim mbi zbatimin e projektit, mospërmbyshja e rregulloreve të BE-së kërkon një deklaram shpjegues të arsyeshëm dhe të justifikueshëm.

Konsulenti do të këshillojë Agjencinë e Zbatimit të Projektit nëse është e nevojshme dhe do t'i raportojë KfW-së mbi saktësinë e procedurës.

4.3 Organi rregullator i brendshëm ERE është përgjegjës për të përcaktuar tarifën e rrjetit të transmetimit që Agjencia e Zbatimit të Projektit do të vërë në ngarkim të përdoruesve të rrjetit. Me qëllim që të përftojë një bazë të përshtatshme tarifash në pajtim me metodologjinë shqiptare për tarifën, Agjencia e Zbatimit të Projektit do të depozitojë aplikime tarifash dhe do të diskutojë modifikimet e tarifave me bazë vjetore me ERE-në në kohën e duhur që i mundësojnë asaj të përmbushë detyrimet e saj për shlyerjen sipas nenit 2.1 të Marrëveshjes përkatëse të Huasë dhe Projektit dhe të kapitalizojë sendet financiare të financuara sipas huasë jo më vonë se pranimi provizor i atyre sendeve pasurore ose në një datë të mëparshme të mundshme. Agjencia e Zbatimit të Projektit do të informojë KfW-në çdo vit mbi aplikimin e tarifave vjetore për ERE-në dhe mbi statusin e kapitalizimit të sendeve pasurore të financuara sipas projektit para njoftimit të ERE-s.

4.4 Agjencia e Zbatimit të Projektit do të kontribuojë për ngritjen e Zyrës së Ankandit të Bashkërenduar (CAO) ose një mekanizmi transparent për alokimin e kapaciteteve të transmetimit ndërkufitar të energjisë elektrike e një përshtatshmërie të ngjashme, dhe merr pjesë në të pasit të jetë ngritur CAO-ja.

5. Dispozitat për operimin e përshtatshëm të projektit

Për të garantuar operimin e përshtatshëm të projektit, Agjencia e Zbatimit të Projektit paraqet një koncept për operimin dhe mirëmbajtjen, të përpiluar në bashkëpunim me konsulentin të paktën 6 muaj para autorizimit të projektit.

Në të njëjtën kohë, Agjencia e Zbatimit të Projektit i paraqet KfW-së dhe Huamarrësit një parashikim financiar, të përpiluar në bashkëpunim me konsulentin, për sferën e operimit ku gjendet projekti. Ky parashikim është për të treguar që është siguruar financimi i operimit të projektit. Agjencia e Zbatimit të Projektit përditëson në mënyrë periodike këtë parashikim dhe siguron që çdo boshllëk financiar të mbulohet në kohën e duhur. Agjencia e Zbatimit të Ligjit ia transmeton pa vonesë këtë parashikim financiar dhe versionet e tij të rishikuara KfW-së dhe Huamarrësit.

III. Lista e mallrave dhe shërbimeve dhe procedura e disbursimit

1. Lista e mallrave dhe shërbimeve

1.1 Lista e mallrave dhe shërbimeve që financohen nga huaja përgatitet mbi bazën e kontratave të lidhura për këto mallra dhe shërbime. Për pasojë, KfW-së i jepet origjinali ose një kopje e secilës prej kontratave dhe e çdo kontrate ndryshuese përkatëse.

1.2 Nëse një masë e projektit duhet të zbatohet dhe nuk ka asnjë marrëveshje paraprake, KfW-ja merr, në mungesë të kontratave, një grafik të masave të planifikuara, të detajuara në kategoritë kryesore të kostos ("grafiku i masave pa marrëveshje paraprake"). Kostot e shkaktuara për administrimin e përgjithshëm në lidhje me punët pa marrëveshje paraprake nuk duhet të përfshihet në grafikun përkatës të masave pa marrëveshje paraprake.

1.3 KfW-ja informon me kërkesë Agjencinë e Zbatimit të Projektit për shumën e huasë që ajo ka rezervuar për financim (lista e mallrave dhe shërbimeve).

2. Procedura e disbursimit

Disbursimi rregullohet nga rregulloret sipas parashikimit në aneksin nr. 6 (Procedura e disbursimit) që përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Në pajtim me nenin 3.1 të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit, kërkesat e disbursimit sipas Marrëveshjes së Huasë dhe Marrëveshjes së Projektit bëhen gjithmonë vetëm njëkohësisht me kërkesat e disbursimit sipas Marrëveshjeve Plotësuese të Huasë dhe janë të vlefshme vetëm nëse shumën e kërkuar të disbursimit përmbushen me raportin e mëposhtëm: 77% (me fjalë: shtatëdhjetë e shtatë për qind) të shumës së plotë të disbursuar të huasë sipas Marrëveshjeve të Huasë duhet të parapaguhet sipas Marrëveshjes së Projektit dhe Huasë, ndërsa pjesa e mbetur prej 23% (me fjalë: njëzet e tre për qind) të shumës së plotë të disbursuar të huasë sipas Marrëveshjeve të Huasë duhet të parapaguhet sipas Marrëveshjeve Plotësuese të Huasë. Kjo e fundit përbëhet nga dy pjesë (10 750 000 euro dhe 500 000 euro), nga të cilat pjesa e parë disbursohet plotësisht e para.

IV. Raportimi dhe dispozita të tjera

1. Raportimi

1.1 Nëse nuk parashikohet ndryshe, Agjencia e Zbatimit të Projektit i raporton KfW-së në çdo tre muaj mbi përparimin e projektit (raportet e progresit), duke përfshirë përmbushjen e marrëveshjeve të zbatimit të parashikuara në seksionin II.4 të kësaj Marrëveshjeje dhe mbi

zhvillimin e të gjitha kushteve të tjera të rëndësishme dhe të përgjithshme. Raporti përfshin pikat e renditura në aneksin 7. Përveç kësaj, Agjencia e Zbatimit të Projektit raporton për të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë arritjen e objektivit të përgjithshëm, qëllimin e projektit dhe rezultatet. Në momentin e përfundimit fizik dhe autorizimit të projektit, por jo më vonë se skadimi i periudhës së garancisë, Agjencia e Zbatimit të Projektit paraqet një raport përfundimtar mbi masat e zbatuara. Raporti i parë mbi gjendjen e punëve paraqitet tre muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit. Raportet duhet të jenë marrë nga KfW-ja jo më vonë se 4 javë pas përfundimit të periudhës së shqyrtimit. Raportet siglohen nga konsulenti.

1.2 Nëse Agjencia e Zbatimit të Projektit ka ngarkuar konsulentin të shkruajë raportin e progresit dhe/ose raportin përfundimtar, Agjencia e Zbatimit të Projektit komenton mbi raportet ose njeq aprovimin e përmbajtjes nëpërmjet siglimit të raporteve.

1.3 Pas përfundimit të projektit, Agjencia e Zbatimit të Projektit raporton mbi zhvillimin e saj të mëtejshëm (shihni aneksin 7 për hollësi). KfW-ja informon në kohën e duhur Agjencinë e Zbatimit të Projektit mbi përfundimin e periudhës së raportimit.

2. Dispozita të tjera

2.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit i dërgon KfW-së të gjitha ato dokumente që janë të nevojshme për KfW-në të bëjë komente dhe të japë aprovimet e përmendura më sipër ose në udhëzimet e bashkëlidhura në momentin e duhur për të dhënë kohë të arsyeshme për shqyrtim.

2.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit do të vendosë tabelat e projektit që do të përmbajnë të paktën mesazhin e mëposhtëm:

"Një projekt zhvillimi i Republikës së Shqipërisë, i bashkëfinancuar nga Republika Federale e Gjermanisë nëpërmjet KfW-së".

Një vulë projekti e dhënë nga Ambasada Gjermane do të vendoset mbi tabelën e projektit.

2.3 Dispozitat e mësipërme mund të ndryshohen ose modifikohen në çdo kohë me marrëveshje reciproke, nëse kjo do të duket e dobishme për zbatimin e projektit ose zbatimin e Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit. Në të gjitha aspektet e tjera, dispozitat e nenit 13 (Përfaqësimet dhe deklaratimet) dhe 14 (Dispozita të përgjithshme) të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit zbatohen përkatësisht për këtë Marrëveshje.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin tuaj për Marrëveshjen e mësipërme duke nënshkruar në një formë ligjërishit të detyrueshme dhe duke kthyer kopjet e bashkëlidhura.

Jeni të lutur t'i paraqisni konsulentit në kohën e duhur një kopje të kësaj letre.

Me respekt,

KfW

Anekset

Aneks 1: Objektivat dhe rezultatet e projektit dhe përgjegjësitë për arritjen e tyre

Aneks 2: Grafiku kohor

Aneks 3: Kostoja dhe financimi i përgjithshëm

Aneks 4: Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim

Aneks 5: Udhëzime për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punëve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim

Aneks 6: Procedura e disbursimit

Aneks 7: Përmbajtja e forma e raportimit

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, ___ dhjetor 2009

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit

Operatori i Sistemit Transmetimit (OST) sh.a.

Njohur nga:

Për Huamarrësin, përfaqësuar nga Ministria e Financave

ANEKSI 1
Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
Detajet e projektit

Objektivi i përgjithshëm
Fuqizimi i një zhvillimi të qendrueshëm të Shqipërisë së Jugut me një furnizim elektrikiteti të përmirësuar dhe një kontribut pozitiv në mbrojtjen e klimës

Treguesit për objektivin e përgjithshëm

Ne e marrim në konsideratë kontributin në synimin kryesor të projektit, nëse objektivi i projektit është arritur.

Supozime për arritjen e objektivave të përgjithshme

- Nuk ka konflikte të jashtme apo çrregullime të brendshme
- Nuk ka vonesa të tepruara në reformën ekonomike në sektorin energjetik

Objektivi i projektit
Përmirësimi cilësor dhe sasior i furnizimit me energji Shqipërisë së Jugut dhe reduktimi i dëmtimeve mjedisore lokale dhe globale

Treguesit për objektivin e projektit

Themelimi i kapacitetit të transmetimit të energjisë prej 130 MV në Shqipërinë e Jugut, me një disponueshmëri vjetore prej se paku 98%.

Përmirësimi i profilit të vo100

Itazhit nëpërmjet një reduktimi të devijimeve nga norma 21 % e linjës 110 kV në maksimumin prej 5%. Reduktimi i nxjerrjes së CO2 prej deri në 10 000 t CO2 në vit, nëpërmjet një reduktimi të humbjeve të transmetimit nga 8% në 2%.

Supozime për arritjen e objektivave të projektit

Furnizimi i mjaftueshëm me elektricitet në Shqipërinë e Jugut.

Tarifat dhe pagesat e transmetimit për konsumatorët rriten për një afat të mesëm dhe me një nivel reflektues të kostos.

Personeli i kualifikuar mbetet në OST dhe pajisjet mirëmbahen siç duhet.

Rezultati 1
Eshtë gati për operim një linjë e re 110 kV nga Babica në Sarandë.

Rezultati 2
Himara dhe Orikumi janë lidhur me rrjetin kombëtar të transmetimit secila nëpërmjet linjave të degëzuara

Rezultati 3
Eshtë gati për operim një linjë e re 110 kV nga Erseka në Përmet

Rezultati 4
Janë gati për operim: Një linjë e re 110 kV nga Korça në Ersekë dhe një linjë e re 110 kV nga Përmeti-Këlcyra dhe Memaliaj.

Rezultati 5
Janë përfunduar një transformator 400/110 kV në Zemlak dhe një linjë 110 kV Zemlak-Korçë.

- Ndërtimi i linjës 110 kV nga Babica në Sarandë

- Ndërtimi i një linje 110 kV të lidhur me linjën e re 110 kV Babicë-Sarandë (shiko rezultatin 1)

- Ndërtimi i linjës së re 110 kV Përmet-Ersekë

- Ndërtimi i një linje të re 110 kV Korçë-Ersekë dhe shkatërrimi i linjës së vjetër

- Rehabilitimi Shtirrije nënstation Zemlak

- Përmirësimi i nënstationeve në Babicë dhe Sarandë

- Rikonfigurimi i rrjeteve shpërndarës në Himarë dhe Orikum

Shtirrije e nënstationeve në Përmet-Ersekë

- Shtirrije e nënstationeve Korçë, Këlcyrë Memaliaj

- Ndërtim i linjës së re 110kV Zemlak-Korçë, lëndë ekzistuese

- Ndërtimi i linjës së re 110 kV Përmet-Këlcyrë-Memaliaj dhe shkatërrim i të vjetrës

Masat e kërkuara për më shumë se një rezultat

Tenderimi i linjave, izolatorëve, lëndëve, bazamenteve etj.

Supozime për arritjen e rezultateve

Njëësia e Zbatimit të Projektit siguron kontributin e saj plotësisht dhe në kohë.

ANEKSI 2
Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
Grafiku kohor i projektit

Pun.	Përshkrim i detajuar Komponentet e Projektit I-II	Mbasq.	Kohëzgjatja e punës (në ditë)																																																	
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50
	Gjithë koha e Projektit- Faza I		[Grafiku i punës për Faza I]																																																	
1	Masa Përfundimtare		[Grafiku i punës për Masa Përfundimtare]																																																	
1.1	Trenat për shprehje teknike, Zgjedhja dhe krahimi i kontr. për shprehje teknike		[Grafiku i punës për Trenat për shprehje teknike]																																																	
1.2	Skica bazë e projektit dhe projekti dhe dok. të tenderave të projektit		[Grafiku i punës për Skica bazë e projektit dhe projekti dhe dok. të tenderave të projektit]																																																	
1.3	Agjencimi i Skicës Bazë		[Grafiku i punës për Agjencimi i Skicës Bazë]																																																	
1.4	Vlerësimi i tenderit dhe propozimi për zgjedhjen e kontrakt. të mirëmb.		[Grafiku i punës për Vlerësimi i tenderit dhe propozimi për zgjedhjen e kontrakt. të mirëmb.]																																																	
1.5	Negocimi i kontratit dhe hartimi i tij		[Grafiku i punës për Negocimi i kontratit dhe hartimi i tij]																																																	
1.6	Lidhja e kontratit		[Grafiku i punës për Lidhja e kontratit]																																																	
2	Shtrirja e lidhjeve ose rrethit elektrifikues		[Grafiku i punës për Shtrirja e lidhjeve ose rrethit elektrifikues]																																																	
2.1	Mbledhimi i skicës së detajuar		[Grafiku i punës për Mbledhimi i skicës së detajuar]																																																	
2.2	Kontroll i skicës dhe miratimi nga kompania		[Grafiku i punës për Kontroll i skicës dhe miratimi nga kompania]																																																	
2.3	Blerje e tokës		[Grafiku i punës për Blerje e tokës]																																																	
2.4	Kryerja e punimeve civile		[Grafiku i punës për Kryerja e punimeve civile]																																																	
2.5	Prodhimi i materialit		[Grafiku i punës për Prodhimi i materialit]																																																	
2.6	Parimi dhe hartimi i kontratit për transportin dhe instalimin		[Grafiku i punës për Parimi dhe hartimi i kontratit për transportin dhe instalimin]																																																	
2.7	Vendosja e punëve dhe materialit		[Grafiku i punës për Vendosja e punëve dhe materialit]																																																	
2.8	Testimi		[Grafiku i punës për Testimi]																																																	
2.9	Vendosja e punëve dhe aktiviteti i instalimit, Punimet finale në vend.		[Grafiku i punës për Vendosja e punëve dhe aktiviteti i instalimit, Punimet finale në vend.]																																																	
##			[Grafiku i punës për ##]																																																	
3	Lidhja e transportit 110KV		[Grafiku i punës për Lidhja e transportit 110KV]																																																	
3.1	Mbledhimi i skicës së detajuar, shprehjet teknike dhe kontratit		[Grafiku i punës për Mbledhimi i skicës së detajuar, shprehjet teknike dhe kontratit]																																																	
3.2	Miratimi nga kompania		[Grafiku i punës për Miratimi nga kompania]																																																	
3.3	Kryerja e punimeve civile		[Grafiku i punës për Kryerja e punimeve civile]																																																	
3.4	Prodhimi dhe materialit		[Grafiku i punës për Prodhimi dhe materialit]																																																	
3.5	Parimi dhe hartimi i kontratit për transportin dhe instalimin		[Grafiku i punës për Parimi dhe hartimi i kontratit për transportin dhe instalimin]																																																	
3.6	Vendosja e punëve dhe materialit		[Grafiku i punës për Vendosja e punëve dhe materialit]																																																	
3.7	Testimi i lidhjeve		[Grafiku i punës për Testimi i lidhjeve]																																																	
3.8	Vendosja e punëve dhe aktiviteti i instalimit, Punimet finale në vend.		[Grafiku i punës për Vendosja e punëve dhe aktiviteti i instalimit, Punimet finale në vend.]																																																	
##			[Grafiku i punës për ##]																																																	

ANEKSI 3
Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
Kosto e përgjithshme dhe financimi

Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut		Kostot totale	Kostot lokale	Kostot e jashtme	Financimi FC	Kontributi i OST	
Komponenti I							
Pos.	Vlerësime të kostove	Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro	
1	110kV Babicë-Sarandë	90km	0,0				
		Përcjellës			3,3	3,3	
		Izolator			0,6	0,6	
		Shtylla		3,7		3,7	
		Themel		1,2		1,2	
		Te ndryshme (mbikëqyrje, instalime, pjesë nderimi)		2,1		1,7	
		Shtirrije e SarandëSS + Babice SS					0,4
					0,6	0,6	
		Pajisje HV					0,2
		Punime te themeleve		0,2			
		nentotali 1.1	11,7	7,2	4,5	11,1	0,6
		Himarë SS + Orikum SS					
					5,4	5,4	
		Pajisje HV					0,2
		Punime te themeleve		0,3			
	nentotali 1.2	5,6	0,3	5,4	5,4	0,2	
	Lidhja/ rikonfigurimi i rrjetit shpërndarës ne Himarë + Orikum		2,7				
				1,0	1,0		
				1,1	1,1		
				0,5	0,5		
				0,3	0,1	0,2	
	Te ndryshme (mbikëqyrje, instalime, pjesë nderimi)						
	nentotali 1.3	2,9	1,9	1,0	2,7	0,2	
	Totali (investime) i Komponentit I	20,2	9,4	10,9	19,2	1,0	
	Kontingjenca, rritje çmimi i lendeve te para, pjesëve te nderimit, etj. Konsulence			0,5	3,0	3,5	
					1,9	1,9	
	18%						
	10%						
	Totali i Komponentit I	25,6	9,8	15,8	24,6	1,0	
	Totali i përgjithshëm i Komponentit I				25,6		
Komponenti II							
Pos.	Vlerësime te kostove	Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro	
2	110kV LT Erseke-Përmet	36km					
		Përcjellës			1,2	1,2	
		Izolator			0,2	0,2	
		Shtylla		1,3		1,3	
		Themel		0,7		0,4	0,3
		Te ndryshme (mbikëqyrje, instalime, pjesë nderimi)		0,5		0,5	
		nentotali 2.1	3,9	2,5	1,4	3,6	0,3
		Shtirrije e nënstationeve Erseke dhe Përmet					0,0
					1,7	1,7	
		Pajisje HV					0,1
	Punime te themeleve		0,7		0,6		
	nentotali 2.2	2,4	0,7	1,7	2,3	0,1	
3	110kV LT e Re Korçë Ersekë + çmontimi i linjës se vjetër	36.1km					
		Përcjellës			1,25	1,25	
		Izolator			0,25	0,25	
		Shtylla		1,4		1,40	
		Themel		0,5		0,25	0,25
		Te ndryshme (mbikëqyrje, instalime, pjesë nderimi)		0,7		0,80	
		nentotali 3.1	4,15	2,6	1,50	3,90	0,25
		Shtirrije e nënstationit ne Korçë + punime te rehabilitimit te nevojshme					
					0,40	0,40	
		Pajisje HV					0,30
	Punime te themeleve		0,5		0,20		
	nentotali 3.2	0,9	0,5	0,40	0,60	0,30	
4	110kV LT e Re Përmet-Këlcyre + çmontimi i linjës se vjetër	43km					
		Përcjellës			1,50	1,50	
		Izolator			0,50	0,50	
		Shtylla		1,7		1,70	
		Themel		0,6		0,60	
		Te ndryshme (mbikëqyrje, instalime, pjesë nderimi)		0,6		0,30	0,30
		nentotali 4.1	4,9	2,9	2,00	4,60	0,30

Shtrirje e nënstacionit ne Këlcyrë dhe Memaliaj + punime te rehabilitimit te nevojshme							
	Pajisje HV			1,70	1,70		
	Punime te themeleve		1,0		0,70	0,30	
nentotali 4.2			2,7	1	1,70	2,40	
5	Krah transformatori ne Zemblak 400 kV	1					
	Pajisje HV			0,7	0,7		
	Punime te themeleve		0,2		0,2		
	Krah transformatori ne Zemblak 110 kV	1					
	Pajisje HV			0,3	0,3		
	Punime te themeleve		0,1		0,1		
	Transformator energjie 150 MVA -400/110 Kv				1,3	1,3	
	Pajisje HV			0,6	0,6		
Instalimi i qarkut te dyte ne linjën ekzistuese te transmetimit 110kV Zemblak-Korçë	13 km		0,3	0,2	0,5		
Punime te lidhura me nënstacionin 400/110 kV Zemblak, SCADA, OPGW, RTU, instalime telecom etj.	set		0,2	0,3	0,3	0,2	
nentotali 5			4,2	1,4	2,8	4	
Totali i madh i Komponentit II (investime)			23,1	11,6	11,5	21,4	
Kontingjenca, rritje çmimi e lendeve te para, pjesëve te nderimit, etj.	11%	2,4	0,4	2	2,4		
Konsulenca	3%	0,6		0,6	0,6		
Totali i Komponentit II			26,1	12	16,1	24,4	
Totali i përgjithshëm i Komponentit II			26,1				
Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë se Jugut		Kostot totale	Kostot lokale	Kostot e jashtme	Financimi FC	Kontributi i OST	
Totali i përgjithshëm Komponenti I+II		51,7	21,8	29,9	49,00	2,7	

ANEKSI 4
Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
Udhëzime për caktimin e konsulentëve të bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim

Jeni të lutur t'i referoheni:

http://www.kfw-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Consultingrichtlinie_E_11_200615701.pdf

ANEKSI 5
Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
Udhëzime për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punëve sipas bashkëpunimit
financiar me vendet në zhvillim

Jeni të lutur t'i referoheni:

http://www.kfw-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Vergaberichtlinie_E_05_2007.pdf

ANEKSI 6
Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
Procedura e disbursimit

Jeni të lutur t'i referoheni dosjes së veçantë.

ANEKSI 6
i Marrëveshjes së Veçantë

Punonjësi përgjegjës: Caroline Möller
Tel: +49 69 7431-3542
email: caroline.moeller@KfW.de

Procedura e disbursimit

**Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshja e Huasë/Financimit/Projektit të KfW-së
37 750 000 Euro nga Marrëveshja e Huasë dhe Projektit
Emri i Projektit/Programit: Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
Numri i Referencës së KfW-së.: 2008 65 188**

1. HYRJE

Ky aneks parashikon procedurën e disbursimit për projektin/programin e sipërpërmendur. Marrëveshja e Veçantë duke përfshirë këtë aneks i ofrohet të gjithë personelit të Huamarrësit, marrësit ose Agjencisë së Zbatimi të Projektit/programit (“Pala e autorizuar”) dhe çdo pale tjetër që është e përfshirë në disbursime.

KfW disburson huatë dhe kontributet financiare të pashlyeshme (“Fondet”) me kërkesë të Palës së autorizuar në pajtim me progresin e projekteve/programit të financuar. KfW-ja mbikëqyr përdorimin kontraktual të fondeve që ajo ka rezervuar për mallra dhe shërbime të caktuara mbi bazën e “Marrëveshjes së Veçantë” që i përkasin Marrëveshjes së Huasë/Financimit/Projektit/Programit. Lista e mallrave dhe shërbimeve, si dhe fondet përkatëse të rezervuara nga kuadri brenda të cilit pala e autorizuar mund të kërkojë disbursimin nga KfW-ja, pasi të jenë përmbushur të gjitha parakushtet për disbursimin.

2. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

2.1 Të gjitha kërkesat për tërheqje:

- tregojnë numrin e referencës së KfW-së;
- numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme, dhe
- nënshkruhen nga përfaqësuesit e palës së autorizuar që janë caktuar si të autorizuar kundrejt KfW-së dhe nga të cilët KfW-ja ka marrë ekzemplarët e firmave (shembull shih shtojcën A).

2.2 Në përgjithësi, KfW-ja pranon vetëm kërkesat origjinale për tërheqje. Nëse, në raste të veçanta, një kërkesë për tërheqje është transmetuar me faks, origjinali duhet të dërgohet me postë menjëherë të shënuar si konfirmim faksi. KfW-ja përjashtohet nga pala e autorizuar nga çdo përgjegjësi për çdo dëm që rrjedh nga transmetimet e gabuara, për shkak veçanërisht të gabimeve në transmetim, abuzimeve, keqkuptimeve ose gabimeve.

2.3 Për pagesat e bëra në një monedhë të ndryshme nga ajo e përcaktuar (“Monedhë e huaj”), KfW-ja debiton huamarrësin ose marrësin me ato shuma që është shpenzuar nga KfW-ja për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet e rastësishme.

2.4 KfW-ja nuk është përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare transmetuese në disbursimin ose dërgimin e fondeve. Nëse një vonesë shkaktohet nga KfW-ja, përgjegjësia e saj kufizohet në pagesën e interesit të mbledhur.

3. DISPOZITA TË VEÇANTA

3.1 Pala e autorizuar është Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).

3.2 Procedura që do të zbatohet

Fondet e caktuara për shërbimet e konsulencës dhe inxhinierike, të përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë I.1.+1.3 disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë.

Fondet e mbetura të caktuara për mallrat dhe shërbimet e përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë I.1. +1.3 disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë.

3.3 Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë (konsulenti)

Për pagesat paraprake dhe të përkohshme konsulenti i paraqet faturat e tij KfW-së duke cituar Numrin e Referencës 2008 65 188 dhe duke i dërguar një kopje palës së autorizuar. Për pagesën përfundimtare, pala e autorizuar do të marrë faturën origjinale dhe do t'i dërgojë një kopje së bashku me një kërkesë të tërheqjes së nënshkruar rregullisht KfW-së duke përdorur një formular standard të KfW-së (shih shtojcën B).

3.3.1 Dokumentet në mbështetje të Kërkesës për Tërheqje, sipas rastit:

- Kopje e faturës së konsulentit;
- Prova për bazën e parashikuar në kontratë për llogaritjen e çmimit në rastin e rritjes së çmimit;
- Lista e shpenzimeve për koston e riimbursueshme që tregon datën, përshkrimin, çmimin, normën e këmbimit, të nënshkruar rregullisht nga konsulenti që tregon që informacioni i dhënë është i vërtetë dhe i saktë.

3.3.2 Dokumente

Të gjitha provat origjinale të shpenzimeve që përputhen me faturat duhet të mbahen deri të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe duhet të mund të shihen në çdo kohë për inspektim nga KfW-ja ose palët e treta të udhëzuara nga KfW-ja (p.sh. auditë) ose i dërgohen me kërkesë KfW-së ose palëve të treta të autorizuar nga KfW-ja.

3.4 Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë

Pala e autorizuar do t'i dërgojë KfW-së një kërkesë të tërheqjes të autorizuar rregullisht (nënshkrime të autorizuar) (shihni shtojcën C), që tregon emrin e përfituesit dhe udhëzimet për pagesë (hollësitë e plota bankare).

3.4.1 Dokumentet që mbështesin kërkesën për tërheqje, sipas rastit:

Në bazë të procedurës së disbursimit të drejtpërdrejtë pala e autorizuar duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme në kërkesën për tërheqje, sipas rastit:

- Kopje të faturave tregtare për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen. Faturat duhet të përpilohen në pajtim me specifikimet e parashikuara në kontratat për mallrat dhe/ose shërbimet.

Përveç kësaj, në rastin kur nuk është kontraktuar asnjë konsulent zbatimi dhe është faturuar shtimi i çmimit:

- prova për bazën e parashikuar në kontratë për llogaritjen e çmimit.
- Kopje të faturës së ngarkesës nëse duhet të paguhet edhe tarifat e transportit dhe nuk janë përfshirë në shumën e kontratës ose nëse paguhet me koston faktike.
- Për furnizimet nga jashtë shtetit, kopje të dokumenteve të transportit (p.sh. fatura e ngarkesës, fatura e transportit, fatura e transportit ajror), duke caktuar emrin dhe flamurin e anijes ose tipin dhe shtetësinë të çdo mjeti tjetër transporti, llojin dhe sasinë e mallrave të transportuara, si dhe vendin dhe datën e dërgimit.

- Sipas rastit, kopje të garancive bankare dhe të certifikatave të pranimit që duhet të jepen në pajtim me kontratën për mallrat dhe/ose shërbimet dhe certifikatat mbi progresin e projektit.

- Një konfirmim mbi faturë nga konsulenti i kontraktuar në zbatimin e projektit, që tregon:
- se mallrat dhe shërbimet e faturuara janë dhënë rregullisht dhe pagesa e tyre është e kërkuar;

- të gjitha dokumentet që paraqiten (duke përfshirë garancitë) janë në pajtim me kushtet e kontratës dhe rregulloret dhe standardet e KfW-së;

- që të gjitha parakushtet për zbatimin e klauzolës së shtimit të çmimit janë përmbushur dhe rritja e çmimit të faturuar është justifikuar.

3.5 Njoftimet e debisë shpërndahen menjëherë te marrësit e Marrëveshjes së Veçantë dhe te palët e tjera të angazhuara që i komunikohen KfW-së nga pala e autorizuar.

3.6 Në pajtim me nenin 3.1 të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit kërkesat e disbursimit sipas Marrëveshjes së Huasë dhe Marrëveshjes së Projektit duhet të bëhen gjithmonë vetëm

njëkohësisht me kërkesat e disbursimit sipas Marrëveshjeve Plotësuese të Huasë dhe janë të vlefshme vetëm nëse shumat e kërkuara të disbursimit përmbushen me raportin e mëposhtëm: 77% (me fjalë: shtatëdhjetë e shtatë për qind) të shumës së plotë të disbursuar të huasë sipas Marrëveshjeve të Huasë duhet të parapaguhet sipas Marrëveshjes së Projektit dhe Huasë, ndërsa pjesa e mbetur prej 23% (me fjalë: njëzet e tre për qind) të shumës së plotë të disbursuar të huasë sipas Marrëveshjeve të huasë duhet të parapaguhet sipas Marrëveshjeve Plotësuese të Huasë. Kjo e fundit përbëhet nga dy pjesë (10 750 000 euro dhe 500 000 euro), nga të cilat pjesa e parë disbursohet plotësisht e para.

Jeni të lutur të kontaktoni punonjës të KfW-së të përmendur më sipër, nëse keni pyetje në lidhje me procedurën e disbursimit, duke cituar numrin e referencës së KfW-së.

Shtojca

- A. Shembull i një letre që përcakton nënshkruarit e autorizuar
- B. Formular kërkesë për tërheqje procedurë e disbursimit të drejtpërdrejtë konsulentët
- C. Formular kërkesë për tërheqje procedurë e disbursimit të drejtpërdrejtë

SHEMBULL I NJË LETRE QË CAKTON NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR

Nga: _____
 Pala e përfaqësuesit të autorizuar sipas Marrëveshjes së Huasë/Financimit/Projektit/Programit

Drejtuar:
 KfW Bankengruppe
 Attn: L3a3
 Postfach 11 11 41
 60046 Frankfurt am Main

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
 Marrëveshja e Huasë/Financimit/Projektit të KfW-së
 37 750 000 Euro nga Marrëveshja e Huasë dhe Projektit
 Emri i Projektit/Programit: Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut

I nderuar zotëri/zonjë,

Në lidhje me Marrëveshjen e Huasë/Financimit/Projektit/Programit për projektin/programin e përmendur më sipër, ne do të donim t'ju informonim që cilido nga personat ekzemplarë të firmave të certifikuar të të cilëve janë në këtë letër, autorizohet t'i nënshkruajë kërkesat për tërheqje në emër të Huamarrësit/Marrësit/Agjencisë së Zbatimit të Projektit/Programit.

- a) Emri:
 Funkzioni:
 Ekzemplari i firmës: _____
- b) Emri:
 Funkzioni:
 Ekzemplari i firmës: _____
- c) Emri:
 Funkzioni:
 Ekzemplari i firmës: _____

Të gjitha shënimet e mëparshme (nëse ka) që jepenin firmat e punonjësve të autorizuar të nënshkruajnë kërkesa për tërheqje sipas këtij kontributi huaje/financiar anulohen.

Me respekt,

 Firma e përfaqësuesit të autorizuar sipas Marrëveshjes së Huasë/Financimit/Projektit/Programit Date

Shënim. Në rastin që një kërkesë duhet të nënshkruhet nga më shumë se një punonjës, autorizimi duhet ta shprehë këtë qartë. Nëse nënshkruarit e autorizuar ndahen në dy grupe, dhe kërkohet firmë e përbashkët, kjo duhet të shprehet qartë.

Nga:

(Adresa e palës së autorizuar)

(datë)

KfW Bankengruppe
TM a
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany

Lënda.: **TM a – Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë**
Marrëveshja e Huasë/Financimit/Projektit të KfW-së
37 750 000 Euro nga Marrëveshja e Huasë dhe Projektit
Emri i Projektit/Programit: Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut

Nr. kërkesës së tërheqjes
Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë (konsulenti)

Në pajtim me kontratat e përcaktuara më poshtë, kopje të të cilave iu janë paraqitur, shërbimet e mëposhtme janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhen:

Nr i zërit *	Kontrata e konsulencës datë me	Fatura e konsulentit nr. datë	Monedha/shuma)

* Artikull i “Listës së mallrave dhe shërbimeve“

Në bazë të “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesës së kërkueshme paguhen nga kontributi i huasë/financiar, që ne u kërkojmë të disbursoni si më poshtë:

Monedha/shuma

.....

Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)

.....

Nr. i llogarisë:.....IBAN (sipas rastit)

Emri i bankës:.....Kodi BIC:

Banka korrespondente:*).....Kodi BIC:

Si provë mbështetëse, një kopje e faturës përkatëse është bashkëlidhur, sipas rastit, së bashku me provat për bazën e parashikuar në kontratë për rritjen e çmimit, listën e shpenzimeve për artikujt e riimbursueshëm.

Ne presim njoftimin tuaj për debinë për disburimet e bëra nga ju.

.....
(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

*) Përveç kësaj, nëse banka e marrësit të pagesës nuk është në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkesat e veçanta kërkohen për çdo monedhë të kërkuar.

Nga:

(Adresa e palës së autorizuar)

(datë)

KfW Bankengruppe
TM a
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany

Lënda.: TM a – Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshja e Huasë/Financimit/Projektit të KfW-së
37 750 000 Euro nga Marrëveshja e Huasë dhe Projektit
Emri i Projektit/Programit: Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut

Nr. i kërkesës së tërheqjes
Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë

Në pajtim me kontratat e përcaktuara më poshtë, kopje të të cilave iu janë paraqitur, shërbimet e mëposhtme janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhen:

Nr. i artikullit*	Kontrata për mallrat/shërbimet datë me ose grafikun e masave (punë pa marrëveshje paraprake) datë	Faturë nr. datë ose grafikun datë	Shuma

* Artikull i "Listës së Mallrave dhe Shërbimeve"
1350

Në pajtim me “Listën e mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesave të kërkueshme do të bëhen nga kontributi i huasë/financiar, që ne kërkojmë të disbursohen si më poshtë:

Monedha/s huma	Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)	Numri i llogarisë/IBAN, sipas rastit	Banka / kodi BIC	Banka korrespondente*)/ kodi BIC

Këto shuma të faturave që nuk paguhën nga kontributi i huasë/financiar janë paguar nga ne si më poshtë:

Monedha/shuma	Përfituesi (shoqëria)	Data e udhëzimit për pagesë dhe banka paguese
.....
.....
.....

Si provë mbështetëse, ne paraqesim bashkëngjitur – sipas rastit: (jeni të lutur t’i referoheni procedurës së disbursimit të aneksit në Marrëveshjen e Veçantë).

..... Fatura e konsulentit (sipas termave të pagesës së kontratës),

..... Faturat e furnitorit (kopje) për çmimin bazë,
 () që përmban konfirmim nga konsulenti,

..... Faturat e furnitorit (kopje) për një rritje çmimi mbi bazën e një klauzole për rritjen e çmimit,

() që ka konfirmimin e konsulentit,

() provë të bazës së llogaritjes

..... dokument ngarkese (kopje)
..... dokument ngarkese (kopje)
..... garanci bankare (kopje)
..... certifikata pranimi
..... certifikatat mbi përparimin e projektit
..... lista e shpenzimeve (punët pa marrëveshje paraprake)
..... (.....) që përmban një konfirmim nga konsulenti (sipas rastit)
..... dokumente të tjera:

Ne presim njoftimet e debisë për disbursimet e bëra prej jush.

.....
(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

*) Përveç kësaj, nëse banka e marrësit të pagesës nuk është në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkesat e veçanta kërkohen për çdo monedhë të kërkuar.

ANEKSI 7
Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
Përmbajtja dhe forma e raportimit

Çfarë duam të dimë?	Si duam të informohemi?	Kush raporton? Sa shpesh? Mbi ç'bazë (burim)?
A. ELEMENTE THELBËSORE DHE MJEDISI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT	Sipas rastit, tregoni zhvillimin me statistika kronologjike. Shpjegoni të gjitha zhvillimet e veçanta. Vlerësoni ndikimet e tyre mbi suksesin e qëndrueshëm të projektit.	Agjencia e Zbatimi të Projektit: çdo semestër nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Huasë dhe Financimit, një vit pas autorizimit: çdo vit
1. A ka mbetur Agjencia e Zbatimit të Projektit një operator i aftë?		
- Pasqyrat financiare (llogaritë e fitimit dhe humbjes, bilanci, pasqyrat financiare vjetore dhe pasqyrat e të ardhurave mundësisht të certifikuara). - A ka gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm? - A është hyrë në ndonjë fushë të re që nga vlerësimi i projektit? - Të dhëna të tjera në varësi të rasteve individuale: Veçanërisht të dhëna të tjera në varësi të rasteve individuale: (p.sh. shifrat e shitjeve, përdorimi i kapacitetit, norma e rikuperimit të shpenzimeve, humbjet në shpërndarje, kostoja e prodhimit, zhvillimi i tarifave, llogaritë e pashlyera).		
2. A janë zhvilluar kushtet ekonomike dhe sektoriale dhe tregu sipas parashikimit?		
- Roli i konkurrencës dhe dhënësit e shërbimit të rëndësishëm për projektin (zhvillimi i cilësisë, çmimit, qëndrueshmëria, hyrja në treg). - Të dhëna të tjera në varësi të rasteve individuale: -Të dhëna të tjera në varësi të rasteve individuale (p.sh. zhvillimi rajonal i popullatës, pjesa e tregut, zhvillimi i çmimit të tregut botëror).		
3. A kanë mbetur të pranueshme impaktet e projektit në mjedis? Jeni të lutur të rendisni ndikimet për zbatimin dhe operimin veçmas:		

Çfarë duam të dimë?	Si duam të informohemi?	Kush raporton? Sa shpesh? Mbi ç'bazë (burim)?
<ul style="list-style-type: none"> - A ka pasur ndryshime në legjislacionin mjedisor me rëndësi për projektin? - A janë dhënë aprovimet që kërkohen nga legjislacioni për mjedisin mbi një bazë të besueshme? - A janë përmbushur standardet mjedisore për autorizimin, dokumentet e detajuara inxhinierike, konceptin operativ, planin dhe detyrimet e menaxhimit mjedisor? - A ka pasur ankesa ose padi në lidhje me impaktet mjedisore? - A janë garantuar kontrollet e parashikuara? - Cilat masa të tjera të mbrojtjes së mjedisit janë parashikuar? 		
1354		

Çfarë duam të dimë?	Si duam të informohemi?	Kush raporton? Sa shpesh? Mbi ç'bazë (burim)?
<p>B. GJENDJA E PËRPARIMIT DHE GRAFIKU KOHOR</p>		<p>Agjencia e Zbatimi të Projektit: çdo semestër nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Huasë dhe Financimit deri në pranimin e të gjitha masave të projektit.</p>
<p>1. Cila është gjendja e përparimit të projektit si i tillë dhe e aktiviteteve individuale të projektit? Hollësitë mund të jepen në tabela që u bashkëngjiten raporteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Caktimi i konsulentit Dhënia e kontratës, afatet, tipi i shërbimit të dhënë, fuqia punëtore e angazhuar lokalisht dhe në zyrën mbështetëse. - Dhënia e kontratave për shërbimet dhe mallrat Afatet, marrëveshjet mbi specifikimet, publikimet, rezultati dhe vlerësimi i ofertave, propozimet për dhënien e kontratave, konsultimi mbi kontratat për mallrat dhe shërbimet. - Sjellja e mallrave dhe dhënia e shërbimeve (detajuar sipas listës së përbërësve të projektit ose kontratave të furnizimit) Mallrat: tipi dhe volumi, afatet e furnizimit, garancitë e dhëna, inspektimi përfundimtar nga prodhuesi, pranimi. Transportet: tipi dhe volumi, kohëzgjatja, siguracioni, magazinimi në vendin e ndërtimit. Punë ndërtimi: tipi dhe volumi, makineria e përdorur, fuqia punëtore e angazhuar, pranimi i punës së ndërtimit. Punë instalimi: tipi dhe volumi, makineria e përdorur, fuqia punëtore e angazhuar, personeli i furnitorëve. Udhëzime për personelin: tipi dhe objekti, numri, kualifikimi i personelit operativ, trajnimi i avancuar te furnitori. Autorizimi: dorëzimi përfundimtar, provat, rezultatet e operimit, korrigjimet, ngjarjet e garancisë (tipi dhe objekti, pasojat). - Aktivitete të tjera Studime paraprake, dhëniet, tipi dhe objekti, afatet, personel, material, trajnim i jashtëm, pranim. 	<p>Agjencia e Zbatimit të Projektit/Konsulenti regjistron të gjitha masat e parashikuara të projektit dhe kontratat kryesore në pajtim me matricën e informacionit në kolonën B.1. dhe i përditëson ato në çdo raport.</p>	

Çfarë duam të dimë?	Si duam të informohemi?	Kush raporton? Sa shpesh? Mbi ç'bazë (burim)?
2.A mund të vihet në operim projekti në momentin e parashikuar?	Përditësimi i aneksit 2 të Marrëveshjes së Veçantë. Krahasim për përmbushjen e objektivave. Shkaqet e shmangieve dhe masat për korigjimin e tyre. vlerësimi i ndikimit të shmangieve në momentin e komisionit. Vlerësimi i efektivitetit të masave përkatëse korigjuese. Pasoja financiare dhe të zhvillimit.	
3.A mund të përmbushë detyrat e saj organizata e projektit, veçanërisht në funksionet e bashkërendimit?	Krahasimi për përmbushjen e objektivave të organizatës së projektit. Shkaqet dhe vlerësimi i shmangieve. Cilat masa korigjuese, sipas rastit janë të nevojshme?	

Çfarë duam të dimë?	Si duhet të informohemi?	Kush raportton? Sa shpesh? Mbi ç'bazë (burim)?
C. KOSTOJA DHE FINANCIMI I PËRGJITHSHËM	Përditësimi i aneksit 3 të Marrëveshjes së Veçantë. Krahasim për përmbushjen e objektivave. Shkaqet për devijimet dhe masat korrigjuese, përveçse kur është shpjeguar sipas B. Pasoja të devijimit në koston e përgjithshme dhe financimin e projektit dhe qëndrueshmëria e tij tregtare.	Agjencia e Zbatimit të Projektit ose konsulenti: çdo semestër nga ftesa për në tender deri në dorëzimin përfundimtar.
1. A është siguruar financimi i projektit gjatë gjithë kohëzgjatjes?		
2. Sa nga fondet e përgjithshme të projektit dhe të grantit FC (me hollësi) janë përdorur, dokumentuar dhe disbursuar në fund të periudhës nën shqyrtim?		
3. Në cilën shumë janë mbledhur fondet nga interesa të ndryshëm dhe si janë përdorur?		
D. OPERIMI I PROJEKTIT DHE PËRMBUSHJA E PROJEKTIT		Agjencia e Zbatimit të Projektit ose konsulenti: çdo semestër deri pas 1 viti pas autorizimit, pastaj dy herë në vit, duke filluar nga nënshkrimi i huasë dhe marrëveshja e financimit.
1. A janë përmbushur përgjegjësitë mbi arritjen e rezultateve, qëllimi i projektit dhe objektivi i përgjithshëm?	Krahasimi ndërmjet situatës faktike dhe situatës ekzistuese e përshkruar në aneksin 1 në lidhje me rezultatet dhe objektivat. Shkaqet për çdo devijim. vlerësimi i pasojave të shmangieve mbi suksesin e përshtatshëm të projektit. Cilat masa duhet të merren për përmbushjen e objektivave; vlerësoni efektivitetin e tyre dhe implikimet financiare.	
2. A mund të arrihen rezultatet, qëllimi i projektit dhe objektivi i përgjithshëm? Kur?	Krahasimi ndërmjet situatës faktike dhe situatës ekzistuese e përshkruar në aneksin 1 në lidhje me rezultatet dhe objektivat. Shkaqet për çdo devijim. vlerësimi i pasojave të shmangieve mbi suksesin e përshtatshëm të projektit. Cilat masa duhet të merren për përmbushjen e objektivave; vlerësoni efektivitetin e tyre dhe implikimet financiare.	
3. A ka ndodhur ndonjë zhvillim apo mund të pritet që të rrezikojë suksesin e qëndrueshëm të projektit (duke përfshirë cilësinë e raportit ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit nga njëra anë dhe grupin e synuar dhe çdo institucion bashkëpunues ose firmë nga ana tjetër)?	Marrja parasysh e deklarimeve të bëra sipas (A).	
4. A janë bërë të nevojshme masat shtesë? A janë bërë të tepërta aktivitetet e planifikuara të projektit?	Masat e emrave, duke treguar: natyrën, përmbajtjen, kohëzgjatjen, fillimin/fundin, agjencinë përgjegjëse, procedurën e mundshme të prokurimit, koston dhe financimin.	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 5.4.2010
Doli nga shtypi më 7.4.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 44 lekë